

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë
Master Profesional “Marketing”, me profile:
1. Turizëm;
2. Inovacion;
3. Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh;
4. TV Multimedia;
5. Marrëdhënie Publike Politike
i Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i
Tiranës”**

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Dr. Elvira Tabaku
2. Grisilda Miftari MSc.
3. Ina Keçi MSc.
4. Rutencja Cengu

Tetor, 2019

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i ciklit të dytë të studimit Master Profesional ‘Marketing’ me profile, është hapur me VKM, Nr. 74, datë 21.01.2009, dhe ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, njësi bazë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, i riorganizuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Nr. 527, datë 04.09.2018. Programi i studimit realizohet me 60 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik (2 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master Profesional” në “Marketing”, me profile: 1.Turizëm;2.Inovacion;3.Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh;4.TV Multimedia;5.Marrëdhënie Publike Politike. Në vitin 2018, programi i është nënshtruar procesit të akreditimit periodik (Vendimi i BA, Nr. 31, datë 13.07.2018) por si pasojë e riorganizimit, do i nënshtrohet sërish këtij procesi. Periudha e vlerësimit përfshin vitin akademik 2018-2019.

Programi i studimit Master Profesional Marketing me profile ofron kryesisht formim praktik, për arritjen e objektivave profesionale sipas profilit të zgjedhur, me qëllim kualifikimin e studentëve në këtë fushë. Masteri Profesional Marketing i ofron studentëve njohuri të specializuara në marketing. Marketingu është një nga mjetet më të rëndësishme dhe më të fuqishme në botën e biznesit dhe studimi i tij është me rëndësi për të gjitha fushat e biznesit. Programi i studimit siguron një mundësi unike për studentët, për të fituar njohuri të specializuara të marketingut përmes detyrave dhe projektit/esesë kërkimore në përfundim të studimit. Gjithashtu ky program formon ekspertë dhe specialistë cilësorë në aspektet teorike, veçanërisht praktike aplikative në fushën e tregjeve, të standardeve, marketingut, reklamës dhe promocionit, çmimeve, etj. Qëllimet e këtij programi studimi përfshijnë pajisjen e studentëve me njohuritë themelore teorike, me praktikat bashkëkohore ndërkombëtare dhe me përvojën shqiptare në fushën e ndërtimit, funksionimit dhe menaxhimit të strukturave të specializuara në fushën e marketingut, të biznesit dhe të ekonomisë, në përgjithësi, analizës dhe funksionimit të tregjeve specifike, psikologjisë së marketingut dhe negociatat në marketing etj.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Raporti është përgatitur nga një Grup ekspertësh i ngritur me Urdhër të Rektorit, Nr. 3, datë 04.03.2019, në përputhje me dispozitat ligjore të MASR dhe ASCAL, si dhe me Statutin dhe Rregulloren e UET. Në përzgjedhjen e anëtarëve të Grupit është mbajtur parasysh kompetenca profesionale, përvoja mësimdhënëse, aftësitë analizuese, mundësitë për mbledhjen dhe për përpunimin e informacionit për të kryer një vlerësim të paanshëm, shkalla e nevojshme të njohjes së institucionit, si dhe profili individual profesional. Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Në konsultim me personelin akademik dhe studentët, anëtarët e Grupit në analizën e tyre kanë vënë theksin në përmbajtjen akademike të programit, në cilësitë e personelit akademik përgjegjës për realizimin e tij, në vlerësimin e infrastrukturës dhe mjedisit në dispozicion, si dhe në parametra të tjerë me rëndësi për procesin e akreditimit.

Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet ligjore e nënligjore përkatëse, në mënyrë të veçantë udhëzimet e ASCAL-it, si edhe ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të UET-it. Grupit i janë vënë në dispozicion dhe ka shfrytëzuar në mënyrë racionale të dhënat që nevojiten për procesin e akreditimit.

Ecuria e procesit është ndjekur nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Zyra e Standardeve dhe Cilësisë, të cilët kanë asistuar GVB dhe kanë koordinuar procesin e mbledhjes së të dhënave. GVB ka zhvilluar takime të herëpashershme me të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces, takime të fokusuara në orientimet e nevojshme në lidhje me procesin e hartimit të raportit të vlerësimit të brendshëm, udhëzuesit dhe template-t për shkrimin e raportit. Gjatë takimit të parë u propozua dhe u miratua dhe plani i punës, me hapat dhe afatet deri në dorëzimin e draftit përfundimtar të raportit.

Vlerësimi I Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Marketing” me profile

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Referuar pikës 1.1. të Vizionit të Strategjisë së Kërkimit Shkencor (2017 – 2020), synohet kthimi i UET në një qendër ekselence që të japë produkt cilësor kërkimor me kontribut të rëndësishëm në planin kombëtar dhe me impakt rajonal ¹ . Këtë, UET përpiqet t’a realizojë nëpërmjet bashkëpunimit me partnerë të besueshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Konstatohet se programi i studimit Master Profesional Marketing, është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, misionin, objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të UET, dhe kërkesat e tregut të punës për specialistë të aftë në këtë fushë. Emërtimi i programit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur.
Kriteri 2. Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në thelb të objektivave kryesore për mbështetjen dhe realizimin e strategjisë së UET është konsolidimi i vlerave akademike dhe kulturore duke krijuar një bazë të gjerë dhe të përshtatshme dijeshe në shërbim të vendit duke promovuar standartet e demokracisë në Shqipëri, zhvillimin ekonomik dhe rajonal, si dhe përmbushjen e aspiratave për zhvillimin e brezit të ardhshëm ² . Nëpërmjet këtij programi studimi, UET synon të krijojë, zhvillojë dhe transmetojë njohuritë në sajë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke përditësuar dhe zgjeruar bazën teorike dhe praktike të kurrikulës së studimeve. Gjithashtu, sipas pikës 3.2 të objektivave strategjike të Strategjisë së Kërkimit Shkencor (2017 – 2020), UET synon të kontribuojë në progresin e dijes njerëzore, në krijimtarinë dhe praktikën profesionale, me qëllim që të krijojë vlera për shoqërinë dhe ekonominë nëpërmjet transferimit të dijes përtej komunitetit akademik, tek institucionet publike e private dhe grupet e interesit ³ .
Kriteri 3. Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit “Master Profesional Marketing” me profilet: Shërbime dhe Turizëm, Inovacion, Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh, TV dhe Multimedia dhe Marrëdhënie Publike Politike është hartuar në bazë të misionit të UET, për t’ju dhënë studentëve një edukim cilësor, me qëllim që të ndërtojë një shoqëri të së ardhmes, bazuar në dije. Nëpërmjet pasurimit të këtij programi

¹ Plani Strategjik 2015-2020, Vizioni, pika 1.1, (Ref. Nr.3).

² Plani Strategjik 2015-2020, Objektivat, (Ref. Nr.3).

³ Strategjia e Kërkimit Shkencor 2017-2020, Objektivat Strategjike, pika 3.2, (Ref. Nr.3.1).

	studimi me profile të reja, UET përmbush plotësisht orientimin e parë strategjik “ <i>Sigurimi i shumëllojshmërisë së ofertave të formimit, përshtatja e metodave dhe e niveleve të financimit për to dhe zgjerimi i sistemit</i> ”, në përputhje me nevojat e zhvillimit perspektiv të vendit, si pjesë e Strategjisë së Mësimdhënies, pesë vitet e fundit.			
Kriteri 4. Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Ky program është riorganizuar, duke u mbështetur në studimin “Alumni” të bërë nga institucioni mbi nevojat e tregut dhe perspektivat ekonomike të vendit. Programi është në përputhje të plotë me kërkesat për zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar.			
rShkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Programi i studimit Master Profesional Marketing përbën një arritje cilësore për objektivat akademike të Fakultetit. Nëpërmjet këtij programi studimi, UET synon të krijojë, zhvillojë dhe transmetojë njohuritë nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në funksion të përditësimit dhe zgjerimit të bazës teorike dhe praktike të kurrikulës së studimeve. Kjo përputhet plotësisht me objektivat strategjike të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si pjesë e strategjisë për zhvillim të vetë institucionit ⁴ .
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	UET ka hartuar dhe miratuar edhe Strategjinë e Kërkimit Shkencor në UET ku përcaktohen drejtimit kryesore për zhvillimin e institucionit. Në përputhje me pikën 1.2 të Vizionit të Strategjisë së Kërkimit Shkencor “ <i>Kërkimi shkencor në UET është në funksion të rritjes cilësore të mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafit akademik, transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët si dhe përfshirjes së këtyre të fundit në veprimtari kërkimore</i> ” fusha e studimit të këtij programi, lidhet drejtpërsëdrejti me një nga drejtimit e mëdha të kërkimit shkencor në UET ⁵ .
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e	Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, pjesë e Fakultetit të Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit. Programi emërtohet Master Profesional Marketing, dhe është i degëzuar në pesë profile, si: Shërbime dhe Turizëm,

⁴ Statuti UET (Ref. Nr.2).

⁵ Strategjia e Kërkimit Shkencor, Vizioni pika 1.2, (Ref.Nr. 3.1).

drejtimet akademike të institucionit.	Inovacion, Menaxhim dhe Vlerësim Projektsh, TV dhe Multimedia dhe Marrëdhënie Publike Politike. Këto profile pajisin studentët me njohuritë themelore teorike, me praktikat bashkëkohore ndërkombëtare dhe me përvojën shqiptare në fushën e ndërtimit, funksionimit dhe menaxhimit të strukturave të specializuara në fushën e marketingut, të promocionit dhe reklamave në sektorë të ndryshëm të biznesit dhe të ekonomisë.			
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	Programi i studimit të ciklit të dytë “Master profesional” është hartuar duke përshtatur kurrikulën, në përputhje me standardet më të mira evropiane dhe duke ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Ky program është hartuar duke u mbështetur në objektivin 2.1 të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020), si edhe në përputhje me direktivat evropiane për profesionet e rregulluara dhe direktivat e tjera për programet specifike studimore. Në këtë kuadër, gjatë këtij viti akademik ofrohen pesë profile studimi të cilat synojnë përbushjen e nevojave të tregut të punës.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Sipas pikës 3.3.1 “ <i>Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale sipas profilit të zgjedhur, me qëllim punësimin, ose kualifikimin në një drejtim të ngushtë</i> ” tek qëllimi dhe objektivat e programit të studimit, pjesë e Rregullores së Programit të studimit Master Profesional Marketing ⁶ , konstatojmë se programi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, lidhur me dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët të përfundim të programit të studimit sic specifikohet gjithashtu edhe në pikën 3.3.2. “ <i>Koncepte të aplikuara, të specializuara; Përgatitje të lidhur ngushtë me profesionin e rregulluar ose licencën/at; Formim nëpërmjet kurseve praktike, aplikative, laboratorëve; Aftësi praktike aplikative në profesionin përkatës; Njohuri teorike bazë të fushës së studimit; Mundësi për stazh, internship të zgjeruar në operatorët kryesorë të tregut të punës; përfshirje në shoqatat profesionale, korporatat profesionale; Aftësim për zhvillim karriere dhe integrim në tregun e punës; Diplomë të karakterit praktik, aplikativ, në formën e një studimi</i> ”

⁶ Rregullore Mësimore e Programit të Studimit pika 3.3.1 (Ref.Nr.7).

	<p><i>rasti, punë praktike ose produkt profesional.” të së njëjtës rregullore⁷. Programi siguron mundësi shumë të mira për punësim, në format e shprehura më poshtë:Ekspertë e drejtues të zyrave të marketingut, shitjeve dhe marrëdhënieve me klientët në biznese të llojeve të ndryshme;Ekspertë e drejtues të agjencive turistike, të reklamave e atyre publicitare, shërbimeve të ndryshme, etj; Ekspertë dhe drejtues të bizneseve të specializuara në aktivitete import eksporti;Drejtues në sektorin financiar, në bankat dhe sigurimet në sferën e marketingut financiar dhe për shërbime për klientët;Ekspertë të media marketingut, medias në përgjithësi etj.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Gjatë hartimit të programit të studimit Departamenti është konsultuar me përfaqësues të rëndësishëm të tregut të punës. Rekomandimet e Bordit të Punës, si dhe të studentëve “Alumni”, pjesë të këtij Bordi, pasqyrohen vazhdimisht në programet e lëndëve dhe në gamën e lëndëve me zgjedhje që ofrohen. Duke qenë se edhe vetë studentët që ndjekin studimet në këtë program janë të punësuar, mendimi i tyre ka një rëndësi të madhe në këtë drejtim. Si pjesë e projektit PERFORM, UET ka organizuar takime me grupe ekspertësh, në lidhje me atë që universitetet ofrojnë dhe tregjet e punës kërkojnë.</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Në përputhje me pikën 3.1.1 të Rregullores Mësimore të programit të studimit⁸ përcaktohet se ky program studimi është i organizuar në 5 grupe, lëndë të kategorisë A. Disiplina e formimit të përgjithshëm, lëndë të kategorisë B. Disiplina e formimit karakterizues të programit, lëndë të kategorisë C. Disiplina me zgjedhje e organizuar në pesë profile. Secili profil përbëhet nga tre lëndë Gjithashtu, ky program ka dy kategori të tjera: D. Veprimtari formuese, Lënda Praktikë dhe Zhvillim karriere dhe kategoria E. Diploma. Ky program studimi është 60 kredite dhe zgjat një vit akademik, në përputhje me pikën 3.1.2. të Rregullores Mësimore të programit të studimit⁹.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e</p>	<p>Rregullorja Mësimore e Programit të Studimit në pikën 9.1 të saj specifikon përputhshmërinë e programit të studimit me parimet e Kartës së Bolonjës, duke mundësuar transferime nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera¹⁰. Të gjitha nënçështjet e tjera të rregullores përcaktojnë hapa të detajuara</p>

⁷ Rregullore Mësimore e Programit të Studimit pika 3.3.2 (Ref.Nr.7).

⁸ Rregullore Mësimore e Programit të Studimit pika 3.1.1 fq. (Ref.Nr.7).

⁹ Rregullore Mësimore e Programit të Studimit pika 3.1.2 fq. (Ref.Nr.7).

¹⁰ Rregullore Mësimore e Programit të Studimit pika 9.1. (Ref.Nr.7).

studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.	proçedurën për njohjen e krediteve në rast të transferimit të programit të studimit ¹¹ .			
Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikat e mira të vendeve evropiane.	Sipas pikës 13.1 të Nenit 13 të Rregullores së Përgjithshme, studimet në UET ¹² , në të gjitha ciklet e studimit, janë si rregull me kohë të plotë, të organizuara në module ose lëndë dhe të shprehura në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS), në frymën e Kartës së Bolonjës. Gjithashtu në kreun 4 të Statutit të UET, neni 29 pikat 29.1 dhe 29.2 përcaktohet se forma e studimeve në UET është si rregull me kohë të plotë shprehur në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe sipas standardeve të zonës evropiane të studimeve, gjithashtu cilësohet se Programet e studimit mund të ofrohen dhe në një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit European, në programe të studimit, të miratuar në aktin përkatës të hapjes ¹³ .			
Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	UET ka 15 marrëveshje të shkruara me organizatat partnere, për praktikat mësimorë dhe zhvillim karriere. Disa prej tyre janë të lidhur drejtpërsëdrejti me programin studimor Master Profesional Marketing. Lista e marrëveshjeve gjendet në Aneksin bashkëlidhur raportit ¹⁴ .			
Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	Programi i studimit është i pajisur me syllabus ¹⁵ në gjuhë të huaj, anglisht. Gjithashtu, stafi akademik i brendshëm ka kualifikimet e duhura për të ofruar mësimdhënien në gjuhën angleze për secilën nga lëndët e programit. Në varësi të kërkesave të studentëve “exchange”, si pjesë e programit Erasmus plus, janë bërë përshtatje për ofrimin e mësimdhënies për çdo kategori lënde. Konstatojmë, një mungesë të organizimit të orëve mësimore në grupe Erasmus. Mësimdhënia organizohet individualisht në periudha të ndryshme. Referuar Kriterit 4 po të këtij standarti, 12 studentë Erasmus pjesë e departamentit, kanë përfituar mobiliteti ¹⁶ studimesh në universitete të ndryshme, me të cilat UET ka partneritet.			
Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësisht të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	Ky program studimi ka qënë ekzistues por këtë vit akademik, duke u përshtatur me kërkesat e tregut të punës, është përditësuar dhe riorganizuar në 5 profile, si: Shërbime dhe Turizëm, Inovacion, Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh, TV dhe Multimedia dhe Marrëdhënie Publike Politike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

¹¹ Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës (Ref.Nr.39)

¹² Rregullore UET, pika 13.1 neni 13. (Ref.Nr.5)

¹³ Statuti i UET, kreu IV, neni 29, pika 29.1 dhe 29.2 (Ref.Nr.2)

¹⁴ Marrëveshje bashkëpunimi (Ref.Nr.34)

¹⁵ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit (Ref. Nr. 19)

¹⁶ Dokumenti D.II Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin (Ref. Nr. 28)

Standardi I.4	
Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Bazuar në objektivat e programit MP në Marketing me profile, vërehet angazhim serioz i personelit akademik për përmbushjen e tyre. Në syllabuset e miratuara të këtij programi janë shprehur qartë objektivat e mësimdhënies si dhe temat përkatëse për secilën prej moduleve të miratuara. Programi zbatohet tërësisht dhe ka një kordinim të personelit akademik me atë ndihmës dhe administrativ ¹⁷ . Personeli akademik dhe administrativ është i informuar për objektivat e programeve të studimit dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit, përmes një dokumentacioni të gjerë rregullator.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Aktualisht UET ka ngritur dhe ka punuar intensivisht për të konsoliduar strukturën e kërkimit shkencor, të mbështetur në Programin e madh kërkimor “Shqipëria Inovative 2015-2020”, të përbërë nga 7 projekte kërkimore, brenda të cilave integrohen drejtimet e mëdha kërkimore dhe akset kërkimore individuale të profesorëve të UET. Personeli akademik është nxitur të marrë pjesë në projekte kërkimore, konferenca e aktivitete të tjera shkencore, të publikojë rezultatet e punës kërkimore, duke përfituar edhe mbështetje financiare përmes akordimit të granteve kërkimore vjetore. Institucioni ka nxitur dhe mbështetur anëtarët e personelit akademik që të avancojnë në shkallët e kualifikimit të tyre akademik, duke krijuar lehtësira për t’iu përgjigjur përmbushjes së kërkesave ligjore për pjesëmarrje në konferenca, publikimin e artikujve shkencorë apo monografive, mobilitetin e personelit në institucione të tjera të arsimit të lartë ose ato kërkimore jashtë vendit.
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve	UET zhvillon dhe transmeton dije si edhe përgatit specialistë, të cilët mund të kontribuojnë në zhvillimet lokale, kombëtare dhe rajonale si dhe proceset integruese rajonale, ballkanike dhe mesdhetare. Në këtë kontekst dhe për këtë qëllim personeli akademik i programit Master Profesional në “Marketing” në UET kanë kontribuar për të organizuar veprimtari të rëndësishme, në bashkëpunim me universitete dhe institucione të tjera publike apo private të vendit dhe të huaja. Këto janë organizuar brenda dhe jashtë vendit, duke u fokusuar në çështjet e demokracisë,

¹⁷ Rregullore Mësimore (Ref.Nr. 7).

kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	zhvillimit të shkencave sociale, reformave juridike, demokratizimit të partive politike, zgjidhjeve të konflikteve, zhvillimin ekonomik të vendit dhe të rajonit, trashëgimisë kulturore dhe historike, migracionit, zhvillimit të tregut të punës, sinergjisë midis arsimit dhe tregut të punës etj.			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.	Për këtë lloj programi nuk ka një drejtim specifik jashtë profilit të institucionit, ndaj ky kriter nuk aplikohet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Në përmbushje të disiplinave të formimit të përfshira në këtë program studimi sigurohet bashkëpunimi ndërmjet disa departamenteve për lëndët të cilat burojnë jashtë Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut ¹⁸ . Konkretisht: lënda Metoda Kërkimi dhe Statistikë buron nga Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara, Fakulteti Shkencave Juridike Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare; lëndët Animacion 3D, Dizajn digjital i personazheve, Audio dhe Vidio Media burojnë nga Departamenti i Arteve të Aplikuara, Fakulteti i Shkencave Humane Edukimit dhe Arteve Liberale; lëndët Marrëdhënie publike të organizatave, Marrëdhënie publike politike dhe Menaxhim eventesh burojnë nga Departamenti Shkenca Humane dhe Komunikim Fakulteti i Shkencave Humane Edukimit dhe Arteve Liberale.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë	Institucioni ka krijuar disa marrëveshje dhe marrëdhënie bashkëpunimi me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, me objekt, si: Ndërtimin e kapaciteteve, shkëmbimin e burimeve njerëzore, ndërtimin e programeve të reja të studimit, etc. Lista e detajuar e bashkëpunimeve gjendet në Aneksin e raportit ¹⁹ .

¹⁸ Dokumenti F.IV – F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit (Ref. Nr. 6)

¹⁹ Marrëveshje bashkëpunimi (Ref.Nr.34)

vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	
Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	UET ka nënshkruar 15 marrëveshje me biznese dhe institucione, që i vijnë në ndihmë studentëve të programit të ciklit të dytë “Master Profesional Marketing” për praktikat mësimorë dhe zhvillim karriere ²⁰ . Krahas këtyre marrëveshjeve, UET gjatë këtij viti akademik 2018-2019 ka organizuar Panaire pune dhe karriere për secilin fakultetet. Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, në të cilin bën pjesë ky program studimi ofron për studentët mundësi kontakti për Internship-e dhe punësim, me 50 kompani më të njohura në fushën e biznesit.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	Pjesë e marrëdhënieve zyrtare dhe bashkëpunuese ndërmjet UET dhe botës së biznesit nuk janë vetëm 15 marrëveshjet e nënshkruara me biznese dhe institucione, por UET i krijon mundësinë studentëve të sigurojnë praktikën mësimore edhe në institucione të tjera jashtë listës së marrëveshjeve të shkruara. Bashkëlidhur, gjeni një listë të Institucioneve/kompanive në të cilat studentët e këtij viti akademik të Mastër Profesional Marketing kanë zhvilluar praktikat e tyre.
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Faza e parë e praktikës mësimore është dorëzimi i Formularit të aplikimit të praktikës, ku studentët propozojnë Institucionin/Kompaninë ku do ndjekin praktikën ²¹ . Një pjesë e konsiderueshme e tyre shfrytëzojnë punësimin e tyre si praktikë, pjesa tjetër shfrytëzon listën e përmendur më lart për marrëveshjet që UET ka lidhur me 15 biznese për praktikë mësimore dhe zhvillim karriere. Konstatohet se këtë vit akademik nuk ka lindur nevoja që UET të ofrojë si Institucion vetë praktika mësimore, por në vitet e mëparshme ka ofruar për disa studentë praktika në zyrën e PR dhe Aktiviteteve, gjithashtu edhe në zyrën e Pranimeve. Gjithësesi, ky numër studentësh është relativisht i vogël.
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Shumica e studentëve të cilët ndjekin programin e studimit master profesional Marketing janë të punësuar dhe shfrytëzojnë punësimin e tyre si praktikë. Pjesë e dosjes së praktikës është një relacion në formën e raportit të praktikës që lidhet me tre çështje kryesore; Informacione të përgjithshme lidhur me Institucionin/ Kompaninë ku kanë kryer praktikën; Detyrat dhe projektet konkrete me të cilat janë angazhuar, si dhe një reflektim lidhur me kontributin e programit specifik të studimit në eksperiencën e tyre gjatë javëve. Në fund, dorëzohen në department të gjitha dosjet e studentëve që kanë mbrojtur praktikën, së bashku me një format tabelar që tregon listën e studentëve dhe institucionet/kompanitë specifike ku kanë ndjekur praktikën. Shpesh realizohen vlerësime lidhur me

²⁰ Marrëveshje bashkëpunimi (Ref.Nr.34)

²¹ Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale (Ref.Nr.32.1)

	përqindjen e praktikave në institucione publike ose kompani private.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
<p>Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Ky program studimi është i organizuar në lëndë e module dhe i vlerësuar me kredite në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe ECTS. Të gjithë lëndët që zhvillohen në këtë program studimi janë konceptuar me 6 kredite dhe ngarkesa orare sipas formave të studimit jepet si më poshtë:</p> <p>Një ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit qe perfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leksionet: 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit • Seminaret: 7 orë në auditor dhe 18 orë punë e pavarur e studentit • Projekt/detyra/ushtrime: 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit • Praktikën Profesionale: 22 orë në auditor dhe 3 orë punë e pavarur e studentit • Punim diplome: 1.5 orë në auditor dhe 23.5 orë punë e pavarur e studentit <p>Sipas pikës 3.1.2 të Rregullores së Programit të Studimit, përcaktohet se shuma totale e krediteve për këtë program është 60 ECTS. Ndër këto studenti merr 42 kredite përmes disiplinave formuese, 6 kredite përmes praktikës profesionale dhe 12 kredite për punimin e diplomës²².</p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p>	<p>Sipas Aneksit të Rregullores së Programit të Studimit, lista e profesioneve/mundësive për punësim pas përfundimit të studimeve në Master Profesional Marketing është: Analist marketing; Analist kërkim tregu; Analist shitjesh; Analist të dhënash dhe informacioni statistikor mbi shitjet e produkteve; Manaxher Marke; Interpretues dhe parashikues i tendencave aktuale dhe të ardhshme të sjelljes</p>

²² Rregullore Mësimore (Ref.Nr.7).

	konsumatore; Konsulent manaxherial per shitjet; Konsulent marketing; Kordinator marketing; Menaxher marketing; Marketing & Media research; Menaxher reklame; Menaxher produktesh; Promovues shitjesh; Specilist promocioni dhe reklame; Studiues i kerkeses potenciale dhe i karakteristikave te tregut per produkte te reja; Studiues i tregjeve të veçanta ²³ .
Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Programi i studimeve Master Professional në Marketing i pajis studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim të mirëfilltë profesional në fushën e marketingut, duke synuar të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve dhe duke u dhënë më shumë mundësi në tregun e punës. Ai arrin ti pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale duke synuar të përmbushen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij. Ky program ka objektiva të qarta profesionale, të justifikueshme, të arritshme, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Ky program studimi merr përsipër të formojë ekspertë dhe specialistë në aspektet veçanërisht praktike aplikative në fushën e tregjeve, standardeve, marketingut, reklamës dhe promocionit, çmimeve, etj. Theksojmë se programet në fushën e Marketingut janë një vlerë dhe risi në ofertën akademike të Universiteteve shqiptare, pasi janë drejtime shumë të kërkuara nga tregu i punës.
Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Programi Master Profesional Marketing me profile që ofrohet në UET është akredituar me Urdhër të Ministrit Arsimit dhe Shkencës Nr. 68, datë 14.02.2011 ²⁴ . Programi është i organizuar në përputhje me udhëzimet e MAS dhe lëndët e modulet vlerësohen me kredite ECTS. Për shkak riorganizimi, programi i është nënshtruar riakreditimit.
Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kreditë.	Gjatë një viti studenti grumbullon 60 kredite, të ndara në mënyrë të balancuar në dy semestra. Sipas fishës së studentit, e cila gjendet në Anekset e raportit, lëndët janë të grupuara sipas profilit përkatës të programit të studimit dhe janë të përcaktuara kreditet specifike për secilën lëndë, gjithashtu dhe semestri në të cilin zhvillohet lënda. Të gjitha lëndët e këtij programi studimit janë të Tipologjisë II, e cila organizohet në katër kategori vlerësimi, aktivizimi në leksion/seminar 10%, detyrë kursi 20%, provim i ndërmjetëm 30% dhe provim përfundimtar 40% ²⁵ .

²³ Rregullore Mësimore e Programit të Studimit, (Ref.Nr.7).

²⁴ Urdhëri i Akreditimit (Ref.Nr.54).

²⁵ Kurrikula e programit (Ref.Nr.14).

<p>Kriteri 7. Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p>	<p>Praktika dhe Zhvillim karriere për studentët e Programit të studimit Master Profesional Marketing është e organizuar në 4 janë në auditor dhe 3 javë në Institucion/Kompani, ku studentët do ndjekin praktikën. Ngarkesa e parashikuar në kredite për praktikën profesionale është 6 ECTS. Ajo zë 10% të totalit të ngarkesës të të gjithë programit, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane. Praktika është e detyrueshme për t'u ndjekur dhe mbrojtur para një komisioni të posaçëm, pjesë e Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut, në përmbushje të detyrimeve të studentit para diplomimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Departamentet si njësi bazë përgjegjëse për realizimin e programeve të studimeve merret me: shqyrtimin dhe miratimin e planeve mësimore, programeve të lëndëve (syllabuseve)²⁶, si edhe propozimin e ndryshimeve që gjykohen të nevojshme; shqyrtimin dhe miratimin propozimeve të përgjegjësve të grup- lëndëve për tekstet mësimore që do të përdoren në lëndët e programit të studimit; ndjekjen e realizimit të programit të studimit sipas planit të miratuar dhe mbikëqyrjen e cilësisë së mësimdhënies duke përmbushur detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut²⁷, që është përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në Marketing me profile, në vitin akademik aktual 2018-2019 përbëhet nga 12 anëtarë të personelit akademik efektiv (PAE) nga ku, 9 prej tyre janë me grada e tituj, dhe 8 personel akademik me kontratë (PAK) nga të cilët 4 janë me tituj/gradë. Përgjegjësi i departamentit është i përfshirë si në procesin e rekrutimit²⁸ të personelit akademik të njësisë së tij, si dhe në vlerësimin periodik të performancës të personelit akademik të njësisë. Te Anekset e Raportit gjeni Matricat për dy semestrat e vitit akademik 2018-2019²⁹.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet</p>	<p>Gjatë vitit akademik 2018-2019, lëndët e programit të studimit Master Profesional Marketing janë të ofruara nga pedagogë të</p>

²⁶ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit (Ref. Nr. 19)

²⁷ Të dhënat tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Ref. Nr. 23)

²⁸ Dokumenti G. Rregullore për Burime Njerëzore, Shembull thirrje për staf akademik (Ref. Nr. 11)

²⁹ Të dhënat tabelore për personelin akademik në programin e studimit (Ref.Nr.24).

ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.	departamenteve të ndryshme, konkretisht të ndarë sipas kategorive të mëposhtme: PAE = Personeli i brendshëm, me kohë të plotë (10 pedagogë) PAK = Personeli i jashtëm, me kohë të pjesshme (2 pedagogë) Të ftuar = 1 (Zak Topuzi)			
Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	UET- ja ka një kuadër rregullativ të brendshëm mbi të cilin mbështetet procesi i punësimit të personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Personeli i angazhuar në programet e ciklit të dytë realizon ngarkesën mësimore sipas akteve në fuqi dhe kontratës së lidhur me UET. Ngarkesa mësimore e personelit akademik angazhuar në programin Master profesional në Marketing realizohet sipas kontratave të lidhura me UET, që përpilohen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ngarkesa mësimore si dhe proceset e tjera akademike si udhëheqjet e diplomave, oponencat, mbikëqyrjet e praktikave profesionale, realizuar nga personeli akademik, vlerësohen me orë mësimore.			
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.	Departamenti, si njësi kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit ka caktuar njëpërgjegjëse të praktikave për departamentin. Detyra e përgjegjëses së praktikave është të asistojë studentët në gjetjen e praktikën; ndihmon studentët në plotësimin e dosjes së praktikës dhe komunikon me studentët gjatë gjithë procesit. Gjithashtu, pjesë e dosjes së praktikës është një formular që pedagogu përgjegjës për praktikën e plotëson për të gjithë studentët.			
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në bazë të vendimit Nr.93 datë 03.12.2018 “Për emërimin e koordinatorëve të programeve të studimit” ³⁰ , institucioni ka përcaktuar koordinatorin e programit të studimit përgjegjës të të cilit përshkruhen në aneksin bashkëlidhur me urdhërin e emërimit.			
Kriteri 7. Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	Koordinatori i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit, duke shqyrtuar hartimin e programeve të lëndëve, ndjekjen e ecurisë së programit dhe hartimin e një raporti periodik vjetor mbi arritjen e objektivave formuese të programit. ³¹			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

³⁰ Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit (Ref. Nr. 36)

³¹ Detyrat dhe përgjegjësitë tek Aneksat e Vendimit për emërimin e koordinatorit të programit të studimit (Ref. Nr. 36)

Standardi II.3	
Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Në syllabuset ³² e miratuara të këtij programi janë shprehur qartë objektivat e mësimdhënies si dhe temat përkatëse për secilën prej moduleve të miratuara. Programi zbatohet tërësisht dhe ka një koordinim dhe angazhim serioz të personelit akademik me atë ndihmës dhe administrative në përmbushjen e objektivave të programit të studimit Master Profesional në Marketing. Personeli akademik dhe administrativ është i informuar për objektivat e programeve të studimit dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit, përmes një dokumentacioni të gjerë rregullator. Institucioni kujdeset për përdorimin optimal të burimeve njerëzore në funksion të realizimit të objektivave të programit, duke vendosur standarde për shpërndarjen e ngarkesës mësimore, dhe balancimin mes mësimdhënies dhe detyrave të tjera të personelit akademik.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Në përmbajtje të këtij programi studimi janë të organizuara lëndët përkatëse të secilit nga pesë profilet e ofruara dhe kreditet e tyre. Për çdo profil programi i studimit ofron tre disiplina formuese të cilat mundësojnë formimin e studentit me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e lidhura me profilin konkret. Krahas disiplinave të formimit të profilizuar program i studimit përfshin dhe një grup lëndësh të detyrueshme të njohura si lëndë bazë, si dhe praktikën e zhvillimit të karrierës si veprimtari formuese e veçantë dhe mbylljen e ciklit të studimit me punimin e diplomës. Organizimi i lëndëve dhe moduleve bashkë me veprimtarinë formuese dhe punimin e diplomës është bërë në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Organizimi i lëndëve dhe moduleve dhe vlerësimi i tyre me kredite për semestrat përkatës është realizuar sipas sistemit vendës e evropian. Informacioni i detajuar për grupimin dhe organizimin e lëndëve me kreditet përkatëse sipas semestrave gjendet tek fisha e studentit, e bashkëlidhur në Anekset e raportit ³³ .
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Ky program studimi ka planin mësimor i cili mund të pasqyrohet në formatin “Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë” ku paraqiten të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me grupimin dhe shpërndarjen e lëndëve sipas viteve akademike, lëndët/modulet përkatëse, semestri kur zhvillohet lënda/moduli, numri i orëve mësim në javë, orët leksion dhe seminar të ndara si orë në auditor dhe orë punë e pavarur,

³² Syllabuset e lëndëve të programit të studimit (Ref. Nr. 19)

³³ Kurrikula (Ref.Nr.14).

	orë për detyra/prezantime dhe orë provimi me ndarjen e ECTS-ve për secilin. Gjithashtu, plani mësimormund të pasqyrohet në formatin “Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)” ku paraqiten të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me tipin e veprimtarisë, lëndën/modulin dhe kreditet përkatëse.			
Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Sipas pikave 2.1 e deri 2.10 të dokumentit të Rregullores së Programit të Studimit specifikohen kriteret, dokumentacioni, përzgjedhja e kandidatëve, dhe shqyrtimi i aplikimit lidhur me pranimin në programin e studimit ³⁴ . Gjithashtu në dokumentin e rregullores së programit pika 9 sqarohet procedura e transferimit dhe njohjes së krediteve. Mbështetur në lëndët që përfshihen në të, programi i studimit arrin të trajtojë të gjithë elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, me qëllim vazhdimin e studimeve apo punësimin e studentit. ³⁵			
Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Çdo lëndë ka syllabusin e vet, sipas standardit të UET. Syllabuset hartohen nga pedagogët dhe më pas miratohen nga përgjegjësi i grup-lëndëve. Pas miratimit, u shpërndahen studentëve në fillim të zhvillimit të kurseve. Syllabuset e të gjitha lëndëve të programit të studimit përmbajnë emërtimin e lëndës, në çdo syllabus shënohet viti dhe semestri kur do të zhvillohet lënda, emri i pedagogut që zhvillon lëndën, vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit si dhe njohuritë dhe aftësitë që i jep lënda studentit. Syllabuset ³⁶ janë të detajuara me tema që mundësojnë formimin teorik dhe praktik të studentit, ato përmbajnë ngarkesën në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe kreditet përkatëse. Të gjitha syllabuset përfshijnë: format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës, raportet midis tyre, format e vlerësimit të studentëve, detyrimet e studentit për lëndën, literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Në planin strategjik të hartuar nga UET-ja janë përcaktuar edhe drejtimet kryesore të përmirësimeve për programet e veçanta që zhvillohen nga institucioni. UET harton plane strategjike me qëllim evidentimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit si dhe përmirësimin e mëtejshëm të këtyre rezultateve nëpërmjet përmirësimit të programeve të studimeve. Në planin strategjik 5 vjeçar (2015-2020), bashkëlidhur në Aneks, përfshihet edhe zhvillimi dhe përmirësimi i programeve të studimit. ³⁷			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

³⁴ Rregullore Mësimore e Programit të Studimit, pikat 2.1-2.10, (Ref.Nr. 7)

³⁵ Dokumenti D.I Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve (Ref. Nr. 27.1)

³⁶ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit (Ref. Nr. 19)

³⁷ Plani Strategjik 2015-2020, (Ref. Nr.3).

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Në çështjen 3.1 të pikës 3 të Rregullores së Programit të Studimit Mastër Profesional Marketing përcaktohen të gjitha aspektet e strukturës së programit mësimor lidhur me: organizimin e disiplinave mësimore në 3 grupe, (lëndët bazë dhe të profilit, praktika profesionale dhe punimi i diplomës); mundësitë e profilizimit dhe shpërndarjen e krediteve sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi ³⁸ .
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.	Lëndët në program organizohen në mënyrë që të plotësojnë formimin kërkimor dhe profesional që programi ofron. Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, kryesisht praktik, për arritjen e objektivave profesionale sipas profilit të zgjedhur, me qëllim punësimin, ose kualifikimin në një drejtim të ngushtë.
Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.	Programi u siguron studentëve mundësinë të bëhen pjesë e një studimi që kombinon teorinë dhe praktikën e marketingut për bizneset brenda dhe jashtë vendit. Duke u përpjekur të krijojë specialistë të Marketingut me njohuri në lidhje me strategjitë marketing në profilet përkatëse, synimet e programit lidhen me objektiva për studentin si: të kuptojnë procesin e marketingut të organizatave, strategjitë marketing, menaxhimin e strategjive marketing, etj.; të aftësohen në aplikimin dhe interpretimin e strategjive marketing për biznesit lokal dhe ndërkombëtar; diskutime teorike dhe aplikime praktike në fushën e marketingut. Sipas Fishës së studentëve bashkëlidhur, Lëndët/ modulet për secilin semestër kanë një shpërndarje të barabartë, 30 kredite ECTS ³⁹ .
Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Programi i studimit Master Profesional Marketing me profile, formon ekspertë dhe specialistë të aftë në aspektet teorike si dhe praktike aplikative në fushën e Marketingut të Aplikuar në Shërbime dhe Turizëm; Inovacion, Menaxhim dhe Vlerësim Projektesh; TV dhe Multimedia; Marrëdhënie Publike Politike duke i pajisur ato me njohuritë teorike, me praktikën bashkëkohore ndërkombëtare dhe me përvojën shqiptare në fushën e marketingut të shërbimeve, në sektorë të ndryshëm të biznesit dhe të ekonomisë.
Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues,	Veprimtaritë formuese teorike dhe praktike janë të ndara në: a. Disiplina e formimit të përgjithshëm; b. Disiplina e formimit karakterizues të programit; c. Disiplina me zgjedhje; d. Veprimtari formuese – Praktikë dhe Zhvillim Karrierë; e. Diploma. Secila nga

³⁸ Rregullore Mësimore e Programit të Studimit, pika 3, çështja 3.1, (Ref.Nr.7)

³⁹ Kurrikula (Ref.Nr.14).

transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	veprimtaritë formuese teorike dhe praktike janë të vlerësuara me kredite në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, dhe kjo i mundëson UET-it të pranojë transferime të studentëve nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera.			
Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Çdo vit akademik, syllabuset ⁴⁰ e lëndëve të programit të studimit rishikohen dhe përmirësohen duke përdorur literaturë bashkëkohore të pesë viteve të fundit. Çdo lëndë ka literaturë të detyruar dhe ndihmëse (e rekomanduar) që i vjen në ndihmë studentëve për formimin e tyre teorik dhe praktik.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.	Bazuar në pikën 3.3.2 të Rregullores së programit të studimit Master Profesional Marketing, përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë, duke ofruar njohuri teorike bazë të fushës së studimit; aftësim për zhvillim karriere dhe integrim në tregun e punës dhe aftësi praktike aplikative në profesionin përkatës ⁴¹ .			
Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Bazuar në pikën 3.3.2 të Rregullores së programit të studimit Master Profesional Marketing, programi është i organizuar për të siguruar aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional nëpërmjet: Formim nëpërmjet kurseve praktike, aplikative; Mundësi për stazh, internship të zgjeruar në operatorët kryesorë të tregut të punës; përfshirje në shoqatat profesionale, korporatat profesionale; Përgatitje të lidhur ngushtë me profesionin e rregulluar ose licencën/at ⁴² .			
Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Ky program studimi mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. Të diplomuarit në këtë program studimi formohen për profesionet/mundësi punësimi të cilat janë listuar në Aneksin bashkëlidhur raportit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi

⁴⁰ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit (Ref. Nr. 19)

⁴¹ Rregullore Mësimore e Programit të Studimit, pika 3.3.1, (Ref.Nr.7).

⁴² Rregullorja Mësimore e Programit të Studimit pika 3.3.1. (Ref.Nr.7).

<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Në rekrutimin e personelit akademik merren në konsideratë kërkesat ligjore dhe përcaktimet në rregulloren e brendshme. Kështu një pedagog nuk mund të zhvillojë më shumë se 4 lëndë në vit. Në programet e ciklit të dytë angazhohen pedagogë me grada dhe tituj.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë i angazhuar në realizimin e programit të studimit Master Profesional Marketing përbëhet nga 10 pedagogë, të gjithë janë me tituj/grada. Personeli akademik me kohë të pjesshme⁴³ i angazhuar në realizimin e programit të studimit Master Profesional Marketing përbëhet nga 4 pedagogë, ndër këta 1 është me tituj/grada.</p>
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Anëtarët e personelit akademik që mbulojnë programin e studimit kanë kualifikimet përkatëse dhe fushën e tyre kërkimore të përgjithshme dhe specifike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. Nga 11 anëtarët të personelit akademik me kohë të plotë, 7 prej tyre kanë profil specifik marketingun dhe turizmin si fushë ekspertize. Ndërsa pjesa tjetër plotësojnë profile e tjera të këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional Marketing ka një pedagog përgjegjës për mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale. Pedagogu përgjegjës është pjesë e personelit akademik me kohë të plotë. Këtë vit akademik, 2018-2019, për shkak të riorganizimit, është reflektuar rekomandimi i GVJ në akreditimin e ardhshëm, duke balancuar numrin e udhëheqjeve nga pedagogët e brendshëm të departamentit Menaxhim dhe Marketing, duke ju përmbajtur kritereve dhe standarteve të vendosura. Personeli akademik i angazhuar në udhëheqjen e diplomave të këtij programi studimi është me kohë të plotë dhe të gjithë anëtarët janë me tituj/grada.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve</p>	<p>Për shkak të natyrës së programit të studimit, nuk përfshihen në të realizimi i orëve laboratorike, ndaj nuk UET nuk ka staf të kësaj kategorie.</p>

⁴³ Format Dosje staf akademik me kohë të pjesshme (Ref.Nr.44.1)

laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6				
Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.				
Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut organizon dy takime në vit me Bordin e Tregut të Punës, të përbërë nga Alumni të UET. Rekomandimet që vijnë nga Bordi i Tregut të Punës, si dhe Alumni, pjesë të këtij Bordi, reflektohen në mënyrë të vazhdueshme në përditësimin e këtij programi studimi.			
Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimin të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimin të programit të studimit.	Meqënëse një pjesë e konsiderueshme e studentëve që ndjekin këtë program studimi, janë të punësuar, një rëndësi e veçantë i kushtohet dhe rekomandimeve të tyre për përmirësime të mundshme. Konstatohet se propozimet diskutohen dhe reflektohen në funksion të përmirësimin të programit të studimit.			
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, njësi bazë e programit të studimit Master Profesional Marketing konsultohet dhe merr në konsideratë rekomandimet e studentëve të diplomuar, një pjesë e të cilëve janë anëtarë të Bordit të Tregut të punës.			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesat dhe nevojat specifike lokale dhe zhvillimi.	Departamenti, si njësi bazë e programit të studimit Master Profesional Marketing në bashkëpunim me institucionet publike e private, përditëson, përshtat dhe riorganizon programin në përputhje me kërkesat dhe nevojat specifike lokale dhe të zhvillimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	----------

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucionin i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Në dokumentin e Strategjisë së Mësimdhënies, institucioni parashikon qartë si prioritet thelbësor trajnimin e personelit akademik egzistues dhe të ri për ndryshimin e stilit dhe metodave të mësimdhënies, parë ky si një si një investim i veçantë dhe i kushtueshëm por si domosdoshmëri për zhvillimin e burimeve njerëzore. Krahas trajnimit të personelit akademik strategjia e mësimdhënies e institucionit përshkruan si një tjetër alternativë për pasurimin dhe zhvillimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, edhe angazhimin e personelit akademik në punë të thelluar kërkimore dhe pedagogjike e cila do t'i mundësojë ndjekjen në vijimësi të zhvillimeve më të fundit në fushën përkatëse. Identifikimi i nevojave për kualifikime përditësuese në mësimdhënie aktualisht në institucion realizohet nga sistemi i menaxhimit të brendshëm të informacionit në bashkëpunim me zyrën e burimeve njerëzore por prioritet i të ardhmes për institucionin është ngritja e një sistemi të menaxhimit të performancës për personelin akademik i cili do të thjeshtësonte procesin e identifikimit të personelit akademik që përdor metoda të vjetra mësimdhënieje dhe që duhet të përfitojë nga kualifikimet përditësuese në mësimdhënie. Pjesë e objektivave të strategjisë së mësimdhënies së UET është dhe artikulli i standardeve dhe rezultateve të mësimdhënies dhe të nxënit si dhe përvojat që i dallojnë këto standarte në cikle të ndryshme të studimit dhe rrugët për përmirësim.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Struktura përgjegjëse për zhvillimin e monitorimit gjatë mësimdhënies është përgjegjësi i njësisë bazë, së bashku me përgjegjësat e grup-lëndëve. Ata kryejnë monitorime të personelit akademik dhe ndihmës akademik, me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme gjatë orëve të leksionit dhe seminarit, duke plotësuar një formular vlerësimi, si pjesë e dosjes së çdo anëtari të departamenti.

<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>UET garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve, nëpërmjet mbledhjeve mujore me studentët për të diskutuara rreth problematikave që mund të kenë; vlerësimit me formular/pyetsor anonim nga studentët i cili organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Skedat e pyetësorëve përpunohen përmes programit të përdorur për vlerësimin online dhe i vihen në dispozicion të drejtuesve të institucionit, si edhe në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog. Njëherazi, ato kanë qënë një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së secilit, në disa raste janë shoqëruar edhe me marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm; fokus grupe me studentët. Të gjitha rezultatet e këtyre vlerësimeve diskutohen në mbledhjet e përjavshme të departamentit.</p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, dhe që nga Janari 2011 në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit. Komisioni vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, administrative e financiare të UET-it. Ai ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Veprimtarinë e saj KSBC-ja e zhvillon të organizuar sipas një plani kalendar (Planit të veprimit) të përvitshëm, në të cilin programohen kontrollat në sektorët apo proceset që i nënshtrohen kontrollit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse. Ndërkohë, në mënyrë periodike KSBC informon drejtuesit e fakulteteve, e përmes tyre të gjithë stafin e UET-it rreth rezultateve të kontrolleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njëjësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen Një formë tjetër e sigurimit të cilësisë është dhe kontrolli i provimeve të ndërmjeteme dhe atyre të semestrit. Katër herë në vit KSBC kryen këtë proces, rezultatet e të cilit pasqyrohen në raportet përkatëse.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Të gjitha rezultatet e gjeneruara nga format e ndryshme të monitorimit lidhur me vlerësimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies diskutohen në mbledhjet e departamentit duke u promovuar shembujt e praktikave më të mira dhe duke u nxitur përmirësimi i mëtejshëm i mësimdhënies.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Për programin e studimit Master Profesional Marketing institucioni ka miratuar format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive si: Leksione në auditor, 2 orë në javë për çdo lëndë; Seminarë 1 orë në javë për çdo lëndë; Projekt/Detyra, dy javët e fundit të semestrit, studentët dorëzojnë detyrat e kursit/ projektet për lëndët e zhvilluara, si pjesë e vlerësimit final (20%); Praktikë profesionale 4 javë nga dy orë në auditor dhe 3 javë në institucion/kompani; Seanca metodologjike për diplomën 10 orë në javë gjatë semestrit të dytë përpara mbylljes së punimit të diplomës.
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Në zhvillimin e lëndëve përdoren gjerësisht mjete didaktike si tabela, kompjuteri, projektori, etj. Për disa lëndë specifike të profileve, studentët mund të ndjekin zhvillimin e mësimin duke punuar dhe vetë në kompjuter nëpër sallat e laboratorëve, çka e ka bërë atë shumë tërheqës për studentin dhe që të kuptohet më mirë nga ai. Metoda të tjera për t'u përgjigjur diversitetit përfshijnë diskutime dhe punë në grupe, krijimi i skenarëve të diskutimit të cilët nxisin të menduarit kritik.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formuese dhe kërkesat e punëdhënësve.	Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhet me trajnimin e pedagogëve, si për freskimin e njohurive të tyre mbi metodikën e mësimdhënies, si dhe njohjen e rregulloreve të brendshme të UET. Kujdes më i veçantë i kushtohet trajnimit të pedagogëve të jashtëm, duke vënë theksin jo vetëm në njohjen e specifikave të rregulloreve të UET, por edhe në aspekte metodike dhe të organizimit të mësimin. Pjesë e trajnimeve të ofruara nga institucioni lidhen dhe me përdorimin e sistemit të brendshëm të komunikimit me studentët, LMS ⁴⁴ , në të cilin studenti mund të sigurojë çdo material teorik dhe jo vetëm lidhur me përmbajtjen e lëndës, detyrat e kursit dhe vlerësimet.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të	Personeli akademik dhe drejtuesit akademikë kryejnë veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillimin e UET-it, këshillim për studentët, tutoriat ⁴⁵ dhe detyra administrative, sipas përcaktimeve në Statutin e UET-it dhe Kontratës së lidhur mes tyre dhe UET-it.

⁴⁴ UET LMS Guidë për studentët (Ref.Nr.43.1)

⁴⁵ Dokumenti A.V Mbi tutoriatin, këshillimin akademik dhe këshillimin metodologjik (Ref. Nr. 27.2)

mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.									
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Pjesë e vlerësimit dhe përmirësimit të formave dhe metodave të mësimdhënies në mënyrë periodike duke përfshirë studentët në këtë proces janë mbledhjet mujore të realizuara me studentët nëpërmjet të cilave synohet të identifikohet çdo lloj problematike e mundshme lidhur me procesin mësimor duke përfshirë reflektime dhe sugjerime nga ana e studentëve lidhur me format dhe metodat e mësimdhënies. Gjithashtu në funksion të të njëjtit proces shërben edhe pyetësi i vlerësimit të studentëve në të cilin studentët shprehin mendimet dhe sugjerimet për përmirësime apo ndryshime të mundshme lidhur me pedagogun, lëndën dhe format e metodat e mësimdhënies.								
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.	Përdorimi i metodave interaktive të mësimdhënies si dhe diskutimi nga ana e personelit akademik përshkruhet në syllabusin e secilës prej lëndëve/moduleve të programit të studimit në seksionin “Metoda pedagogjike për seminarin e radhës”. Plotësimi i këtij seksioni është një element i rëndësishëm në formatin e miratuar për syllabuseve ⁴⁶ lëndëve të programit të studimit, duke përshkruar materialet për diskutim dhe rastet studimore për secilën prej temave. Por në këtë program studimi përdorimi i metodave interaktive dhe diskutimit në mësimdhënie nuk limitohet vetëm për orët e seminareve por gjithashtu edhe gjatë leksioneve, ku materialet e leksioneve nuk përfshijnë vetëm literaturën por edhe materiale audivizuale të cilat krijojnë situata diskutimesh duke mundësuar zhvillimin e leksioneve interaktive.								
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Metodat interaktive të mësimdhënies dhe diskutimet gjatë orëve në auditor mundësojnë organizimin dhe angazhimin e studentëve në grupe pune. Nëpërmjet punës në ekipe studentët e këtij programi studimi nuk aftësohen vetëm në diskutimin e koncepteve teorike të cilat do ti ndihmojnë në formimin e kompetencave dhe aftësive profesionale sipas profileve përkatëse të përzgjedhur prej tyre, por aftësohen gjithashtu për inkurajimin e autonomisë duke punuar në mënyrë të pavarur dhe në ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

⁴⁶ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit (Ref. Nr. 19)

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Për zhvillimin e veprimtarisë universitare, UET zotëron një sipërfaqe ndërtimi totale prej rreth 10,000 m². Godinat e tij kanë përreth një hapësirë të gjerë për lulishte me stola të jashtëm, si dhe vend për parkim për rreth 120 makina. Ato janë të pajisura me dy palë shkallë, për të përballuar rastet e emergjencës si dhe janë të pajisura me mjetet e nevojshme për mbrojtjen kundra zjarrit si: një fikse zjarri në çdo kat, dhe nga një fikse zjarri në burime potenciale zjarri, në total 30 copë, si dhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike, rrufe-pritëse. UET garanton burime alternative për furnizimin me energji elektrike si dhe ka rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm. Mjediset janë të kompletuara me sistem ngrohës me komandim qendror, që funksionon pa ndërprerje dhe ku, janë çertifikuar mirëmbajtje të rregullta të tij nga firma instaluese.</p> <p>Në dispozicion të procesit universitar, UET ka tre godina: Godina A është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m², Godina B është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m² dhe Godina C (biblioteka) gjithsej 300 m², sipërfaqe këto të ndara në: salla leksionesh, gjithsej 10 salla me sipërfaqe totale 1510m² dhe 1515 vende, salla seminari gjithsej 14, me sipërfaqe 45m² dhe secila me nga 35 karrige, salla 70 vendeshe (leksione + seminare) gjithsej 9 salla me sipërfaqe 100m² secila, salla për departamentet gjithsej 8 mjedise me sipërfaqe 45m² secila, zyra për përgjegjës departamenti gjithsej 8 mjedise me nga 18m², zyra për kordinatorët gjithsej 6 mjedise me nga 14m², 3 salla për laborator informatike me sipërfaqe 45m² secila me kapacitet 35 vende, sallë interneti me sipërfaqe 165m² me 80 kompjutera, zyra për pedagogët 30 me sipërfaqe 14m² secila dhe një sallë e madhe me sipërfaqe 150m², me 32 vende pune, salla për bibliotekën me sipërfaqe 300m², 150 vende leximi, mjedisi për fotokopje dhe librari ka sipërfaqe 150m², zyra e informacioni për studentët 2, korridore dhe holle gjithsej 8 me 150m² secili, mjedis çlodhës për kafe/fast-food/etj me sipërfaqe 500m², nyje hidrosanitare gjithsej 48 me sipërfaqe 300m², zyra për dekanin/zv.dekanin/kancelarin 5 me nga 20m², zyra për sekretarinë mesimore 3 me sipërfaqe 140m², zyra për stafin akademik dhe administrativ 12 me sipërfaqe 350m², mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore 3 me sipërfaqe 140m².⁴⁷</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për</p>	<p>UET ka në përdorim 4 laboratorë mësimorë informatike, si laborator 205 B me 25 PC dhe video projektor, ai 206 B me 35 PC dhe video projektor, 207 B me 35 PC dhe video projektor, 208 B me 80 PC dhe 33 salla mësimore, të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni. Biblioteka gjithashtu është e</p>

⁴⁷ Infrastruktura në funksion të programeve të studimit (Ref. Nr. 42)

<p>realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p>	<p>pajisur me PC dhe mjediset universitare janë të mbuluara me sinjal WiFi. Të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor, këtu përfshihen projektorët dhe sistemi i fonisë. Sistemet e operimit janë të gjithë Windows 7, me paketa Microsoft Office 2016 me të gjithë softëerët e saj: Access; Communicator; Excel; InfoPath; OneNote; Outlook; PowerPoint; Publisher; SharePoint Workspace dhe Word. Laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Stafi i Zyrës së IT-së, i angazhuar për mirëmbajtjen e laboratorëve të informatikës, dhe pajisjeve ndihmëse në auditore, është i kualifikuar dhe në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit të mësimi. Mirëmbajtja e pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit. dhe instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale. Programet kompjuterike iu janë përshtatur programeve mësimore duke instaluar programet aplikative që kërkohen nga departamentet përkatëse mësimore. Pranë UET gjendet një personeli administrativ gjithmonë i gatshëm në shërbim të studentëve dhe personelit akademik për të siguruar mbarëvajtjen e procesit akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Në UET funksionojnë sisteme që mbështesin studentin në procesin mësimor, si sistemi UET LMS (Learning Management System), i cili bën të mundur që studenti të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu në kohë reale dhe të komunikojë nëpërmjet sistemit në forume të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek, të shikojë notat dhe pikët online nga kudo që ndodhet.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>UET disponon bibliotekën, me literaturë që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Pasurimi i saj është një përpjekje dhe objektiv i vazhdueshëm i institucionit, duke marrë parasysh dinamikën e publikimeve brenda dhe jashtë vendit. Për realizimin e këtij programi UET siguron tekste mësimore cilësore, që përcaktohen në silabuset e çdo lënde. Biblioteka disponon: 6167 tituj në total nga të cilët: 6005 janë tituj librash dhe 162 janë tituj periodikësh e revistash. Ndër titujt e librave, 4734 janë tituj në gjuhën shqipe dhe 1371 janë tituj në gjuhë të huaj (anglisht, frengjisht, italisht, gjermanisht). Ndër titujt e revistave dhe periodikëve, 102 tituj janë në gjuhën shqipe dhe 60 tituj janë në gjuhë të huaj (anglisht, frengjisht, italisht).</p> <p>Biblioteka ka akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si: EBCSO, Emerald, Cambridge University, Taylor & Francis, Questia, Etj. Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: e Hene- e Premte</p>

	9:00-20:00 dhe e Shtunë 9:00:17:00. Ndërsa gjatë sezonit të provimeve funksionon me orar të zgjatur.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit, konkretisht janë kryer abonime në biblioteka virtuale si: Sage, Ebsco dhe revista shkencore në hard copy, të cilat ofrojnë për studentët dhe stafin akademik mijëra tituj librash dhe artikuj shkencorë bashkëkohorë.
Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	UET ka siguruar infrastrukturën e nevojshme laboratorike pasi ka vënë në dispozicion të studentëve 4 laboratorë mësimorë informatiketë cilët janë të pajisuar me PC, video projektor dhe mjete audio vizive. Ambjentet universitare janë të mbuluara me sinjal Wi-Fi internet në mënyrë që studentët të aksesojnë ëbin. Pajisjet dhe programet e instaluar janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit. ⁴⁸
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Duke filluar nga viti akademik 2016-2017 UET ka vënë në përdorim platformën LMS (Learning Management System) për menaxhimin e mësimdhënies online. LMS është një aplikacion web për administrimin, dokumentimin, ndjekjen, raportimin dhe shpërndarjen e materialeve mësimore dhe informacionit tjetër të rëndësishëm për studentët. Ky sistem ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues të student apo pedagog. Çdo student, apo pedagog që hyn në sistem, merr vetëm informacionin që i përket atij. Njëkohësisht, ai është edhe një mjet eficient në dispozicion të KSBC-së për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit të akademik, përmes të dhënave statistikore të gjeneruara nga ky sistem.
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Sistemi i komunikimit të brendshëm realizohet si nëpërmjet adresave të Email-it të krijuara nga institucioni për stafin akademik, administrativ dhe studentët gjithashtu edhe nëpërmjet sistemit LMS. Funkzioni kryesor i këtij sistemi është të lehtësojë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit dhe informacionit (njoftimet detyrat që duhen dorëzuar, afatet e dorëzimit, etj.) mes pedagogut dhe studentëve, duke ndihmuar në rritjen e cilësisë së mësimnxënies, pasi studenti merr përmes sistemit, gjithë bazën didaktike dhe orientimet e pedagogut për lëndën, si edhe ka mundësi t'i drejtojë atij pyetje për paqartësitë e mundshme.
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Të gjithë studentët që ndjekin këtë program studimi, në fund të semestrit të dytë mbrojnë një punim diplome. Udhëheqësi i tezave është gjithmonë një pedagog me gradë dhe titull, i cili krahas takimeve të personalizuara, zhvillon edhe seanca metodologjike në auditor me grupin e studentëve që udhëheq, për të garantuar një mbarëvajtje të procesit të shkrimit të punimit. Këtë vit akademik

⁴⁸ Infrastruktura në funksion të programeve të studimit (Ref. Nr. 42)

	është reflektuar mbi rekomandimin e GVJ të akreditimit të mëparshëm, dhe pedagogët e departamentit udhëheqin një numër studentësh brenda kriterëve dhe standarteve të vendosur. Studenti njihet me formatin e diplomës dhe suplementet e saj ⁴⁹ , me të cilët do të pajiset në përfundim të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	Sipas pikës 6.1 të broshurës mbi organizimin dhe funksionimin e KSBC, kjo njësi ngrihet në nivel institucioni, antarët e saj propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati i Universitetit. Gjithashtu sipas pikës 7.2 të së njëjtës rregullore përshkruhet se KSBC-ja krijon dhe mban në vijimësi marrëdhënie me institucione pjesëmarrëse në Rrjetin Europian të Sigurimit të Cilësisë, të cilat pas vendimit të Rektoratit, mund të ftohen të zhvillojnë kontrollin e jashtëm të UET-it ⁵⁰ . Qëllimet e kësaj njësie në funksion të koordinimit dhe bashkërendimit me njësitë kryesore bazë në kuadër të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie sipas pikës F.VII.3 në rregulloren e KSBC përfshijnë: Rritja e vazhdueshme e cilësisë së drejtimit të UET-it, nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave, strategjive dhe procedurave bashkëkohore, si edhe angazhimit të të gjitha niveleve drejtuese dhe organizative; aplikimi i vazhdueshëm i filozofisë së UET-it, duke zbatuar një program akademik që përkon si nga ana konceptuale dhe kronologjike me synimet që ka UET-i; rritja e vazhdueshme e cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies dhe duke nxitur të qenin proaktiv e kritik në dhënien e opinioneve mbi çështje aktuale ⁵¹ .
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Njësia kryesore, Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit ka ngritur njësinë përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies, Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Sipas pikës F.VII.1. mbi organizimin dhe funksionimin e KSBC, Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë është garantimi i cilësisë gjatë ushtrimit të veprimtarive akademike, kërkimore, kulturore, shoqërore të personelit akademik dhe të studentëve, si edhe veprimtarive

⁴⁹ Modeli i Diplomës dhe suplementi (Ref. Nr. 15 dhe 15.1)

⁵⁰ Manuali mbi organizimin dhe funksionimin e KSBC, pika 6.1, (Ref. Nr. 37.1)

⁵¹ Plani i veprimit (Ref. Nr. 37.2)

	<p>administrative dhe financiare të UET-it. Objektivat e SBC-së janë: Monitorimi i vazhdueshëm i drejtimit të institucionit; Ndjekja e vazhdueshme e gjendjes së programeve të lëndëve, zbatimit, rishikimit, përditësimit të tyre, nëpërmjet krijimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së mekanizmave zyrtare për miratimin, vlerësimin periodik dhe për monitorimin e programeve dhe diplomave⁵²; Ndjekja e vazhdueshme e nivelit të cilësisë së stafit akademik dhe ndihmës, si edhe kualifikimit të tij; Monitorimi i vazhdueshëm i procesit të mësimdhënies dhe i vlerësimit të studentëve dhe ruajtja e cilësisë së tij; Ndjekja e vazhdueshme e ecurisë së kërkimit shkencor në institucion; Monitorimi i nivelit të përfshirjes së studentëve në veprimtaritë e përditshme të institucionit; Ndjekja e ecurisë së bashkëpunimit të UET-it me institucione të tjera akademike dhe joakademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar; Shtrirja e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë në të gjitha hallkat organizative të institucionit⁵³.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Mësimdhënia dhe të nxënit në UET organizohen në një sërë metodash tradicionale dhe inovative me bindjen se kombinimi i metodave të ndryshme çon në të nxënit aktiv. UET promovon metoda inovative dhe aktive dhe kreative të mësimdhënies dhe të nxënit, të orientuara drejt studentëve. Pedagogët inkurajohen të zhvillojnë leksione me debate, diskutime brenda në klasë, punime individuale dhe në grupe brenda dhe jashtë auditorit. UET angazhohet në sigurimin e standardeve të larta të mësimdhënies dhe të nxënit teorik dhe praktik. Personeli akademik bën të gjitha përpjekjet që studentët të kuptojnë thellësisht konceptet bazë, teoritë dhe praktikat dhe aplikon metoda të ndryshme për kontrollin e shkallës së përvetësimit të lëndëve nga studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>UET organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor në mënyrë periodike. UET u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut si dhe njësia e mbulimit të programit MP në Marketing, realizon leksione të hapura me pjesëmarrje pedagogë të huaj apo specialist të mirënjohur të fushës së marketingut, me synim marrjen e përvojës metodologjike dhe pedagogjike nga stafi i Departamentit. UET nxit përfshirjen e pedagogëve në mobilitete akademike dhe krijon mundësinë për implementimin e metodave të reja të mësimdhënies nëpërmjet shkëmbime eksperiencash nga</p>

⁵² Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit (Ref. Nr. 10)

⁵³ Plani i veprimit – (Ref. Nr. 37.2)

	<p>pedagogë të Universiteteve partnere jashtë vendit. Konkretisht, në dy vitet e fundit numri i stafit akademik të huaj që kanë sjellë ekspertizën dhe përvojën e tyre në UET është 18 lektorë. Gjithashtu, numri i personelit akademik të UET që ka qënë pjesë e mobiliteteve në Universitete partnere është 37 lektorë. Krahas stafit akademik, pjesë e mobiliteteve janë edhe stafi administrativ.</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik është pjesë e trajnimeve të vazhdueshme. Gjithashtu, sekretaria Mësimore⁵⁴ mban evidencat për zhvillimin e orëve të mësimin, leksione/seminare. Ajo raporton në fund të çdo jave, për orët e pazhvilluara te Sekretari i Përgjithshëm, te Dekanët e Fakulteteve dhe te Zyra e Burimeve Njerëzore. Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore monitorojnë zhvillimin e procesit mësimor në përputhje me orarin i cili ishte i shpallur. Përmirësimi mësimdhënies dhe implementimi metodave të reja mundësohet edhe nëpërmjet praktikës së leksioneve të hapura, vlerësimit nga studentë; vlerësimit të Dekanit dhe/ose Përgjegjësit të Departamentit në raste të veçanta të evidentimit të nevojës për përmirësimin e cilësisë; vlerësimit nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës që ngrihet nga Rektori, në fund të çdo viti akademik (follow-up).</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Testimi i metodave të reja në mësimdhënie është një praktikë e cila aplikohet në rastet kur stafi akademik pasuron metodat e mësimdhënies si rezultat i eksperiencave nga shkëmbimet dhe mobilitet Erasmus në universitet partnere me të cilat institucioni bashkëpunon.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Për UET, kërkimi shkencor, inovacioni dhe mobiliteti i stafit janë një pjesë kryesore e strategjisë së zhvillimit institucional. UET është i fokusuar në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për mobilitetet e stafit dhe forcimin e portofolit të kërkimit. UET ofron mobilitete për studentët, stafin dhe kërkuesit për avancimin e kërkimit shkencor dhe rritjen e standardit të produktit të kërkimit shkencor. Mobilitetet tregojnë se UET është angazhuar që studentët, stafi dhe kërkuesit e tij të njihen me praktikën më të mira akademike Europiane në mënyrë që personeli të trajnohet vazhdimisht, të jetë në kontakt me avancimet e fundit në fushat e tyre përkatëse, e për të aplikuar në UET standardet më të larta të mësimdhënies dhe kërkimit. Ristrukturimi i revistave shkencore, trajnimi i vazhdueshëm i stafit lidhur me hulumtimin dhe publikimin dhe mbështetja me një mekanizëm të përshtatshëm</p>

⁵⁴ Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore (Ref. Nr. 9)

	financimi, bën të mundur që stafi akademik i UET të ketë njëkohësisht njohuritë dhe mbështetjen për t'u angazhuar në kërkime akademike me standarde të larta dhe me ndikim në botën akademike dhe politike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5				
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.				
Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kontrolli i njohurive në UET lidhet me qëllimet dhe objektivat e programit të studimit. Përdoren një sërë metodash vlerësimi dhe testimi, për disa forma të procesit të mësimdhënies, të tilla si frekuentimi, diskutimet në klasë, esetë, testimet gjatë vitit dhe provimi përfundimtar. Konkretisht: Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive 10%; Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) 20%; Testimet gjatë vitit 30%; Provimi përfundimtar 40%. Në syllabusin e secilës lëndë të këtij programi studimi përshkruhet një seksion i veçantë lidhur me formën e kontrollit dhe vlerësimit të njohurive. Syllabusi ngarkohet në LMS nga ku mund të aksesohet lehtësisht nga studentët.			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët e programit të studimit marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit, lëndët e modulet e tij. Çdo fillim semestri atyre u vihet në dispozicion në forma të ndryshme programi dhe syllabuset ⁵⁵ e lëndëve që ofrohen. Nëpërmjet syllabuseve atainformohen lidhur me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive (tipologjitë e lëndëve). Konkretisht, në këtë program studimi, të gjitha lëndët janë të Tipologjisë II.			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, si: Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive; Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit); Testimet gjatë vitit; Provimi përfundimtar. Për kryerjen e vlerësimit, përdoren metoda të ndryshme: Teste tëstandardizuara, Dëgjime nëauditor, Vlerësimi me pikë; Testime paraprake dhepërfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera ngastudentët, Vëzhgime gjatë kryerjes sëushtrimeve/praktikës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

⁵⁵ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit (Ref. Nr. 19)

				X
--	--	--	--	----------

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik duke përfshirë vlerësimin për ndjekjene detyrueshme të lëndës dhe pjesmarrjen aktive, vlerësimin për detyrën e kursit, vlerësimin për testimin e ndërmjetëm në përfundim të gjysmës së parë të semestrit dhe në fund vlerësimin për provimin përfundimtar. Të gjitha pikët e secilit vlerësim mblidhen dhe reflektohen në vlerësimin final.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm duke rritur nivelin e objektivitetit dhe transparencën në vlerësimin e studentit. Gjatë vitit akademik 2016-2017 ka filluar të përdoret vlerësimi në mënyrë elektronike (nëpërmjet Clean Score) i provimeve/testimeve, si një nga format bashkëkohore të kontrollit të njohurive dhe vlerësimi i studentëve.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Në këtë program studimi vlerësimi përfundimtar i njohurive lidhur me lëndën PraktikëProfesionale, realizohet me komision me tre anëtarë, ku njëri prej tyre është përgjegjësi i praktikës për departamentin. Studentët vlerësohen në basë të dosjes së praktikës e përbërë nga 5 formularë dhe mbrojtjes së praktikës para komisionit. Vlerësimi i praktikës është kusht për përmbushjen e detyrimeve lidhur me kreditet e programit dhe me diplomimin.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Sipas pikës 5.3.3. të rregullores së programit të studimit Master Profesional Marketing, përshkruhet zhvillimi në mënyrë anonime me sekretim i procesit të testimit dhe vlerësimit të njohurive ⁵⁶ . Konkretisht, në rregullore përshkruhet se provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Vlerësimi i studentit ⁵⁷ me pikë shënohet në fletën e provimit dhe firmoset nga pedagogu që ka bërë korrigjimin në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve.
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës.	Vlerësimi i njohurive dhe dijeve në provim shoqërohet me komente. Çdo provim përmban seksionin e vlerësimit të pedagogut për të argumentuar vlerësimin e tij. Pas secilës detyrë apo provim, pedagogët zhvillojnë seanca sqaruese me studentët, për të sqaruar çdo paqartësi të mundshme në lidhje me vlerësimin e kryer. Pas kësaj seance pedagogu dorëzon procesverbalin me rezultatet e studentëve.

⁵⁶ Rregullorja Mësimore e Programit të Studimit, pika 5.3.3. (Ref. Nr. 7)

⁵⁷ Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve (Ref. Nr. 7.1)

për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.									
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	UET ka implementuar tashmë një sistem antiplagjiaturë, në mënyrë që punimet e studentëve të mund të kalojnë një kontroll elektronik cilësor, të shpejtë dhe efikas, për plagjiaturë përpara se të marrin vlerësimin final nga pedagogët, apo komisionet e vlerësimit përkatës. Për secilin prej anëtarëve të stafit akademik në sistem është krijuar një account/llogari, nëpërmjet të cilës ata mund të kontrollojnë për plagjiaturë punimet që ju dorëzojnë studentët. Secili prej anëtarëve të stafit akademik merr një email të vecantë, konfirmues për krijimin e llogarisë së tyre në sistem.								
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në përputhje me rregulloren e UET, stafi akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, përmbush afatet kohore të dorëzimit të tezave të korigjuara, pranë sekretarisë mësimore, e cila merret me zbardhjen e sekretimeve të provimeve. Dorëzimi i tezave të korigjuara bëhet brenda një jave nga data e zhvillimit të provimit, ndërsa seancat sqaruese dhe rishikuese bëhen brenda 2 javëve nga data e zhvillimit të provimit. Gjithashtu, stafi akademik dorëzon rezultatet e vlerësimit të seminareve dhe detyrave të kursit, gjatës javës së 14-të (të fundit) të semestrit, duke ju përmbajtur afatit përkatës. Studentët njihen me rezultatet para datës së zhvillimit të provimit përfundimtar.								
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	UET garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin e provimeve, detyrave të kursit dhe aktivizimit në seminar, fizikisht dhe elektronikisht nëpërmjet dy sistemeve UMS dhe LMS. Seanca sqaruese ju vjen në ndihmë studentëve duke siguruar feedback mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Studentët kanë të drejtë të bëjnë kërkesë për rishikime vlerësimit të provimit, në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.								
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Në raste të veçanta kërkesë ankimi të provimit, ngrihet një komision i posaçëm për rivlerësimin e provimit, me tre anëtarë, në përbërjen e të cilit nuk është pedagogu i lëndës. Komisioni vendos nëse vlerësimi ka qënë korrekt ose jo, dhe ndërmerr veprimet e nevojshme sipas rastit, duke dhënë rezultatin përfundimtar.								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi

<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit siguron një mundësi unike për studentët, për të fituar njohuri të specializuara të marketingut përmes detyrave dhe projektit/esesë kërkimore në përfundim të studimit. Gjithashtu, ky program siguron për studentët shanse për të fituar ndërgjegjësim, eksperiencë dhe lidhje me industrinë, duke mundësuar aplikimin e njohurive, teknikat dhe aftësitë e tyre për të zgjidhur problemet e kësaj industrie.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Në këtë program studimi veçanërisht profili Inovacion dhe profili TV dhe multimedia ofrojnë për studentët mundësinë e zhvillimit të aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, të komunikimit dhe ndërveprimit.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Në përmbajtje të formatit të miratuar të syllabusit⁵⁸ të secilës prej lëndëve të programit të studimit në seksionin “Përmbledhje dhe qëllimet e kursit” sqarohen kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti. Vlerësimi dhe analizimi i kompetencave dhe aftësive të fituara bëhet në sajë të statistikave të rezultateve përfundimtare të lëndës (të cilat përfshijnë të katër format e vlerësimit të cituara në kriteret e mësipërme) të cilat evidentohen nga pedagogu përkatës i lëndës dhe diskutohen në mbledhje të departamentit për reflektime të mundshme lidhur me qëllimet e programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Seanca e fundit e seminarit trajtohet në formën e njëseance konsultuese qëorienton studentët për testin përfundimtar. Gjatë seancës trajtohen konceptet kryesore, çështjet më të rëndësishme, struktura e përgjithshme e tezës sipas seksioneve dhe udhëzime të tjera lidhur me trajtimin e pyetjeve të provimit.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Çdo lëndë ka të reflektuar në syllabus⁵⁹ orët e programuara nga lektori/lektorët e lëndës për zhvillimin e orëve të hapura dhe seminareve me të ftuar të ndryshëm nga bota e biznesit si dhe diskutimin e çështjeve lidhur me zhvillimet më të fundit në fushën e studimit të cilës i përket lënda.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Si pjesë e raportit final të praktikës profesionale, studentëve iu kërkohet të sjellin një material të shkruar si reflektim i përgjithshëm mbi kompetencat e fituara dhe ndikimin që ka patur programi i studimit në procesin e punës, qasjen ndaj zgjidhjeve të problemeve dhe njohjen e tyre me tregun e punës.</p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e</p>	<p>Diskutimi dhe puna në grup shërbejnë si metoda interaktive të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke ndihmuar studentët në zhvillimin e aftësive analitike konceptuale dhe inovative për</p>

⁵⁸ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit (Ref. Nr. 19)

⁵⁹ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit (Ref. Nr. 19)

problematikave/çështjeve të caktuara.	zgjdhjen e rasteve të ndryshme të studimit si problematika të mundshme të bizneseve. Këto diskutime realizohen në formën e rasteve studimore duke mbështetur debatin konstruktik në funksion të koncepteve teorike.			
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Nëpërmjet udhëzimeve dhe përcaktimit të temave apo rasteve studimore që që përcakton pedagogu i lëndës lidhur me përmbushjen e detyrimeve të kursit, iu krijon studentëve klimën e përshtatshme për zhvillimin e ideve të tyre inovative. Si në rastin e temave specifike apo edhe të rasteve studimore studenti ka mundësinë të aplikojë teorinë dhe konceptet teorike me shembuj dhe raste konkrete të kompanive duke fituar aftësi analitike praktike dhe duke krijuar ide inovative.			
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Pjesë e strategjisë kërkimore shkencore të UET është përfshirja e studentëve në konferenca dhe publikime shkencore me qëllim zhvillimin e ideve inovative dhe studime të avancuara për fusha specifike. Studentët janë përfshirë në konferencën shkencore ndërkombëtare që zhvillon UET, Ditët e Studimeve Shqiptare dhe janë mbështetur financiarisht.			
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Eksperienca që personeli akademik merr gjatë mobiliteteve në institucionet/universitete partnere reflektohet në përmirësimin e formave të mësimdhënies dhe nxit studentët për mobilitete tek partnerët. Gjatë shkëmbimit të eksperiencave promovohen universitetet dhe vendet për të rritur shancet dhe motivimin e studentëve për një eksperiencë jashtë institucionit të tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor, këtu përfshihen projektorët dhe sistemi i fonisë. Sistemet e operimit janë të gjithë Windows 7, me paketa Microsoft Office 2016 me të gjithë softwerët e saj: Access; Communicator; Excel; InfoPath; OneNote; Outlook; PowerPoint; Publisher; SharePoint Workspace dhe Word. Laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet,	Zyra e Karrierës dhe Praktikave mbështet studentët gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve duke ofruar konsulencë për aplikime

garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	dhe shpërndarë informacion për mundësitë e punësimit, apo mundësitë për vazhdimin e specializimeve e brenda ose jashtë vendit me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.			
Kriteri 3. Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale sipas parashikimit në syllabusin e lëndës ka 100 pikë dhe 6 kredite ECTS. Studenti dorëzon dosjen e praktikës të përbërë nga dokumenta të posaçëm shoqëruar me vlerësimin nga pedagogu përgjegjës. Vlerësimi final jepet nga komisioni i ngritur për vlerësimin e praktikave mësimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.9	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike, që në fillim të semestrit. Për t'u diplomuar studentit duhet t'i nënshtrohet një provimi të përgjithshëm formimi, ose të mbrojtë një punim diplome, i cili mund të jetë praktik, aplikativ, studim rasti, punë praktike, produkt profesional dhe që lidhet ngushtë me tematikën që mbulon programin e studimit.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Punimi është i pavarur dhe krijues dhe synon të vërtetojë fitimin e aftësive dhe të kompetencave profesionale ose të njohurive të parashikuara. Personeli akademik asiston studentët nëpërmjet seancave metodologjike, sipas një kalendari takimesh, të shpallur, duke i ofruar atyre ndihmë lidhur me informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Për programin MP "Marketing" me profile, duke qënë se fokusi i programit është përvetësimi i aftësive praktike profesionale nga ana e studentit, edhe provimi përfundimtar si detyrim përmbyllës, synon të testojë pikërisht aftësitë e studentëve për të aplikuar në një rast studimor njohuritë e përfituara nga programi i studimit. Ritestimi teorik i njohurive është gjykuar i papërshtatshëm për një program të llojit Master Profesional, me kohëzgjatje 1 vit. Për rrjedhojë, provimi i përgjithshëm përfundimtar është konceptuar si një rast studimor kompleks, i lidhur ngushtë me profilin studimor të studentit, ku atij do i duhet të aplikojë njohuritë kryesore të përfituara për t'i dhënë zgjidhje gjatë kohëzgjatjes së provimit në klasë (150 minuta).

<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Departamenti gjatë shqyrtimit të propozimeve të studentëve për temën e tezës master garanton që udhëheqësi i propozuar nga studentët të jetë në përputhje me fushën e programit të studimit dhe temën e propozuar. Nëse nuk konstatohet përputhshmëri, atëherë Departamenti cakton një pedagog udhëheqës që i përmbush këto kritere. Studentët njoftohen për listën e miratuar me temat dhe pedagogët udhëheqës. Nëse nuk ka pedagogë të brendshëm të përshtatshëm për të udhëhequr një temë të caktuar, atëherë departamenti ka të drejtë të caktojë në pedagog të jashtëm brenda kritereve të kërkuara. Gjatë seancave metodologjike ofrohet asistencë për përcaktimin e temave të diplomës dhe udhëzime të tjera mbi përmbajtjen e saj.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Përveç 10 seancave metodologjike, të përjavshme gjatë semestrit të dytë, bashkëpunimi ndërmjet studentëve dhe pedagogut udhëheqës zgjat deri në përfundim të dorëzimit të diplomës. Kriteret për paraqitjen e punimit të diplomës përcaktohen me rregullore të veçantë.</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi i diplomës ndjek çdo hap të procesit të përgatitjes së punimit të diplomës dhe ndihmon studentin në përpunimin e të dhënave dhe nxjerrjen e rezultateve. Studenti nuk mund të mbrojë temën e diplomës pa marrë miratimin e udhëheqësit si garantues i cilësisë së saj akademike. Studenti nuk mund të mbrojë punimin e diplomës pa përmbushur të gjitha detyrimet e tjera të programit.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në bazë të vendimit të komisionit të vlerësimit për mbrojtjen e diplomave, studenti vlerësohet me notë. Studenti ka të drejtë të hyjë 2 (dy) herë në mbrojtjen e diplomës. Në rast se edhe pas herës së dytë rezulton mbetës (< 41 pikë), studenti duhet të ndryshojë temën dhe të paraqesë një punim të ri diplome.</p>
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Konstatohet se ky kriter përmbushet dhe në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe listën e plotë të notave, të cilën e tërheq pranë sekretarisë mësimore.</p>
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të programit të studimit çdo student pajiset me diplomën sipas profilit përkatës, suplementin e diplomës, listën e notave dhe sipas kërkesës nga një kopje të syllabuseve për të gjitha lëndët e përfshira në programin e studimit.⁶⁰</p>
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.</p>	<p>Në arkivën e institucionit gjenden kopje të dokumentacionit të studentit që nga koha e regjistrimit në programin e studimit deri në përfundim të studimeve. Çdo dokumentacion është i arkivuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.</p>

⁶⁰ Syllabuset e lëndëve të programit të studimit (Ref. Nr. 19)

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimitor-shkencor dhe administrativ.	Të dhënat e personelit mblidhen, ruhen dhe përditësohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore ⁶¹ , e cila krijon Dosjen Individuale të Stafit Akademik, me kohë të plotë dhe të pjesshme, në të cilat depozitohet i gjithë dokumentacioni ⁶² . Zyra e Burimeve Njerëzore mban evidencë edhe për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër.
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	UET i ka të përcaktuara në dokumentacionin bazë që rregullon veprimtarinë e institucionit, parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme ⁶³ .
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	Politikat dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik janë të parashikuara në dokumentin përkatës, në të cilin përcaktohen fazat nga evidencimi i nevojave për personel të ri e deri tek vlerësimi i performancës së personelit akademik. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Për çdo vend

⁶¹ Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore (Ref. Nr. 11)

⁶² Format Dosje Stafit Akademik (Ref. Nr. 44 & 44.1)

⁶³ Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore (Ref. Nr. 11)

	vakant njoftimet bëhen në faqjen zyrtare të universitetit ⁶⁴ , rrjetet sociale ⁶⁵ dhe në gazetën Liberale			
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit	Vlerësimi i stafit akademik zhvillohet si në momentin e rekrutimit ashtu edhe në vijim. Këto procedura janë të përcaktuara në dokumentet e brendshme të institucionit ⁶⁶ . Përzgjedhja e personelit bëhet duke marrë në konsideratë mungesat në stafin e brendshëm sikurse dhe ekspertizat dhe ngarkesën mësimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Institucioni ka mundur një mjedis të përshtatshëm i cili lehtëson dhe mundëson kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Ky mjedis është i garantuar në terma të infrastrukturës fizike dhe asaj teknologjike. Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit janë të shumta, si: Salla për leksione; Klasa për seminare; Salla për veprimtari promovuese; Salla për praktikë profesionale; Laboratorë informatike; Salla për bibliotekë etj. Të gjitha sallat mësimore (leksione dhe seminare) janë të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni. Sistemi i kondicionimit ndodhet në çdo ambient në UET.
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	UET mbulon shpenzimet për pjesëmarrjen në konferenca dhe trajnime në vend dhe jasht vendit, nëpërmjet granteve, gjithashtu egziston një nxitje dhe motivim institucional për bashkëpunim me institucionet homologe në rajon dhe jashtë vendit. Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë parësore për cilësinë e personelit akademik që mbulon programin e studimit.
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm	Institucioni ofron mundësinë e trajnimeve dhe workshopeve të ndryshme të cilat orientojnë personelin akademik dhe personelin mësimor-shencor në përditësimin dhe kualifikimin e mëtejshëm profesional. Ndër këto trajnime dhe workshope përmendim: trajnimi me temë “Statistical Data Analysis of ESS 2012 Project”

⁶⁴ Faqja zyrtare e UET <http://uet.edu.al/new/thirrje-aktuale-per-punesim/>

⁶⁵ Shembull thirrje për staf akademik (Ref. 11.1)

⁶⁶ Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, Neni 22 (Ref. Nr. 5); Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore (Ref. Nr. 11)

profesional të personelit akademik e të personelit mësues-shkencor.	në kuadër të Anketës Sociale Evropiane (ESS) (Workshop-i trajtoi metodat statistikore, që shërbejnë për të zhvilluar një projekt të tillë); (Workshop “Use of Surveys as Research Method” (pjesë e trajnimeve dhe certifikimeve që zhvillon Qendra për Kërkim Shkencor dhe Metodologji në UET); trajnimi UET LMS strafin akademik etj.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	Personeli akademik është i angazhuar për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Departamenti kontrollon dhe vlerëson punën e tyre nëpërmjet anketimeve të kryera me studentët si dhe kontrollet periodike. Gjithashtu, departamenti mbështet stafin akademik për kryerjen e detyrave në mënyrë efikente dhe efektive.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Në përputhje me rregulloren e programit të studimit, numri i studentëve pjesë e grupit të Master Profesional Marketing, këtë vit akademik dhe jo vetëm, është brenda standartit të kërkuar. Konkretisht, numri i studentëve që ndjekin këtë vit akademik programin e studimit Master Profesional Marketing është 36. Raporti pedagogë /studentë për Masterin Profesional Marketing është brenda parametrave të kërkuara, çka mundëson një përkushtim mjaft të madh të personelit akademik ndaj studentëve të programit.
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit janë të shumta, si: Salla për leksione; Klasa për seminare; Salla për veprimtari promovuese; Salla për praktikë lëndore/ profesionale; Laboratorë informatike; Salla për bibliotekë; Innolab; Zyrë informacioni për studentët; Mjediset për aktivitetet e qeverisë studentore; dhe Hapësira të tjera. GVB vlerëson se të gjitha salla mësimore (leksione dhe seminare) janë të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni në rastin e sallave të leksionit dhe seminareve. Sistemi i kondicionimit ndodhet në çdo ambient në UET. Pajisjet dhe infrastruktura në dispozicion vlerësohen të përshtatshme dhe në përputhje me qëllimet dhe nevojat e zhvillimit

	të mësimdhënies në kushte bashëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. ⁶⁷			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i paisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit. Instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale. Në të njëjtën kohë programet kompjuterike iu janë përshtatur programeve mësimore duke instaluar programet aplikative që kërkohen nga departamentet përkatëse mësimore, për të asistuar në aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formuese të programit të studimit. Për vetë natyrën e programit të studimit nuk kërkohet nevoja e ndonjë mjedisi me natyrë specifike.			
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	UET disponon disa laboratorë të teknologjisë së informacionit që asistojnë studentët të programeve të ndryshme të studimit. Këtë vit akademik, UET ka inaguaruar sallën e re InnoLab, pjesë e një projekt (Innovation Hub) i ideuar dhe i zbatuar nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe i financuar nga Programi Italo-Shqiptar i Konvertimit të Borxhit për Zhvillim-IADSA, i dedikuar për studentët dhe jo vetëm. Kjo hapsirë e dedikuar shërben jo vetëm për aktivitete të lidhura me natyrën e programin të studimit por gjithashtu dhe me klubet studentore aktive të UET. Laboratori i Inovacionit është i pajisur me PC, ambjent për të zhvilluar takime/mbledhje, etj.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Praktika profesionale për programin e studimit Master Profesional Marketing realizohet 4 javë (8 orë gjithsej) në salla leksionesh me të gjitha mjetet e nevojshme për zhvillimin e praktikës në auditor. UET garanton se zotëron kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të praktikës mësimore. Praktika në Institucion këtë vit akademik është zhvilluar në Institucione/Kompani të ndryshme, lista ⁶⁸ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
-----------------	------------------

⁶⁷ Infrastruktura në fuksion të programeve të studimit (Ref. Nr. 42)

⁶⁸ Lista e institucioneve të zhvillimit të praktikës profesionale (Ref.Nr.34)

<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e UET disponon literaturë që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Pasurimi i saj është një përpjekje dhe objektiv i vazhdueshëm i institucionit, duke marrë parasysh dinamikën e publikimeve brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Në fondin e Bibliotekës së UET ka tituj të botuara nga UET-Press, të autorëve shqiptarë ose përkthime nga UET Press. Biblioteka ka një staf të kualifikuar në ndihmë të studentëve si edhe për shërbime të tjera bibliotekare. UET siguron tekste mësimore cilësore, që përcaktohen në silabuset e çdo lënde. Biblioteka disponon: 6167 tituj në total nga të cilët: 6005 janë tituj librash dhe 162 janë tituj periodikësh e revistash. Ndër titujt e librave, 4734 janë tituj në gjuhën shqipe dhe 1371 janë tituj në gjuhë të huaj (anglisht, frengjisht, italisht, gjermanisht). Ndër titujt e revistave dhe periodikëve, 102 tituj janë në gjuhën shqipe dhe 60 tituj janë në gjuhë të huaj (anglisht, frengjisht, italisht). Biblioteka funksionon me orar të gjatë dhe ofron kushte të mira dhe një fond të pasur botimesh hard copy dhe elektronike, në gjuhën shqip dhe gjuhë të huaja, për të mbështetur studentët dhe personelin akademik në punën e tyre studimore dhe kërkimore shkencore.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>UET ka kryer disa abonime në biblioteka virtuale, dhe revista shkencore në hard copy, të cilat ofrojnë për studentët dhe stafin akademik mijëra tituj librash dhe artikuj shkencorë bashkëkohorë, ku mund të përmenden: Sage, Ebsco (abonim 5-vjeçar), Questia; dhe revistat shkencore të huaja: Harvard Business Review, The Economist, Foreign affairs, Commentaire, The Nations Interest, The American Interest, Educational Leadership etj.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me PC dhe mjediset universitare janë të mbuluara me sinjal WiFi. Në këtë mënyrë nëpërmjet kompjuterave në sallën e Bibliotekës, studentët apo edhe stafi akademik mund të aksesojnë shërbimin e bibliotekës virtuale pa asnjë kufizim.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>UET disponon bibliotekën, ku, pasurimi i fondit të saj⁶⁹ bëhet përmes: blerjeve⁷⁰ në fillim të çdo fillim viti akademik i një numri të konsiderueshëm tekstesh universitare dhe librash të reja që janë pjesë e kurrikulave⁷¹ shkollore si tekstet bazë ose si literaturë e rekomanduar; blerjeve në Panairin Kombëtar të Librit në nëntor të çdo viti i botimeve më të rëndësishme që lidhen drejtpërsëdrejti apo tërthorazi me procesin mësimor në të tre fakultetet e UET; përkthimit dhe botimit nga UET Press i shumë teksteve, që kanë për autorë pedagogë të UET, studiues të tjerë shqiptarë dhe autorë të huaj, klasikë dhe bashkëkohorë si dhe</p>

⁶⁹ Dokumenti E-IV-2 Formular për pasurimin e fondit të librave në bibliotekë (Ref.Nr.45)

⁷⁰ Shembull procedurë blerje literature (Ref.Nr.45.2)

⁷¹ Rregullore e zyrës/ njësisë së monitorimit të Kurrikulës (Ref. Nr. 13)

	koleksionet e plota të të gjitha revistave shkencore që botohen nga UET; porosive dhe blerjeve online në Amazon.com e dhjetra apo qindra botimeve të rëndësishme dhe nga më të fundit në gjuhën angleze në ato fusha të shkencës me të cilat identifikohet me së miri ekspertiza e UET.			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: e Hene- e Premte 9:00-20:00 dhe e Shtunë 9:00:17:00. Kurse gjatë sezonit të provimeve është me orar të zgjatur.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Pedagogu i brendshëm ose i jashtëm i kontraktuar rishtas është i detyruar të ndjekë trajnimin metodologjik, të përvetësojë dokumentet UET, Modulin Metodologjik dhe Sistemin e Menaxhimit të Universitetit (UMS) dhe të certifikohet për njohjen e tyre, gjë që përbën kusht për hyrjen në fuqi të kontratës së punës. Studentët informohen individualisht për rezultatet e vlerësimit përmes sistemit UMS dhe LMS.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Në çdo zyrë të stafit akademik dhe administrative, në kompjuterat përkatës gjendet databaza e Institucionit me emërtimin “Dokumenta UET”, ku secili anëtar i institucionit mund të aksesojë në kohë reale të dhëna lidhur me strategjitë, rregulloret, urdhërat administrativ, standartet, dhe çdo informacion dhe dokumentacion tjetër lidhur me aktivitetin e personelit akademik, ndihmësakademik, akademik dhe partnerët të angazhuar në realizimin e programit.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit ofron informacion lidhur çdo hap të procesit mësimor, i cili mund të aksesohet nga personeli akademik në databazën e Institucionit me emërtimin “Dokumenta UET”, ndërsa studentët kanë akses mbi informacionin e programit të studimit për lëndët përkatëse në të cilat rregjistrohen në platformën UET LMS.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module	Personeli akademik dhe studentët mund të komunikojnë virtualisht nëpërmjet platformës së posaçme UET LMS, por

që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	gjithashtu edhe nëpërmjet emailit. Në secilin rast, studentëve u vihet në dispozicion çdo lloj materiali lidhur me lëndët e programit të studimit dhe çdo informacion lidhur me përmbushjen e detyrimeve ndaj kurseve të studimit.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Në kuadër të analizës së cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimit ndaj studentëve në UET analizohet aktivizimi i çdo pedagogu në platformën interaktive UET LMS, për lëndët dhe grupet e veta. Personi përgjegjës për menaxhimin e platformës UET LMS, dërgon në fund të çdo semestri, Raportin mbi aktivitetin e pedagogut ne platformen interaktive LMS duke mundësuar raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Në faqen web të UET pasqyrohen informacione lidhur me të gjitha programet e studimit të ofruara nga institucioni, informacion lidhur me personelin akademik sipas fakulteteve dhe departamenteve përkatëse (kualifikimi dhe cv bio e personelit akademik) ⁷² dhe çdo aktivitet në kuadër të veprimtarisë kërkimore shkencore, leksioneve të hapura si dhe leksioneve nga të ftuar të shquar të botës së biznesit dhe akademisë. Të gjitha këto informacione publikohen në faqen web të institucionit në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe atë angleze.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare është një komponent i rëndësishëm që siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor. Burim kryesor financimi janë tarifatat për dhe gjatë shkollimit, ndërsa një kontribut tjetër lidhet me aktivitetet tregtare (qeradhenie, parkim etj.) Specifike për vitet e fundit 2013-2018 është edhe kontributi i granteve për kërkim, siguruar nga projekte të ndryshme me donatorë të huaj ku U.E.T. është pjesëmarrës. Institucioni bën një auditim të përvitshëm të situatës financiare të tij. Për secilin vit akademik institucioni harton raportin në lidhje me koston për secilin program studimi për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standardeve. Për nevojat e drejtimit ai mban të dhëna krahasuese edhe për vitet e kaluara duke bërë të mundur evidentimin e elementeve kryesore që ndikojnë në performancën e kompanisë, për të dhënë qendrueshmëri dhe rezultat.

⁷² CV e stafit akademik të programit të studimit (Ref. Nr. 20)

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare plotëson standardet e kërkuara. UET respekton standardin e hartimit të raportimit financiar dhe të evidentimit të kostos së studimit.⁷³ Pasqyrat financiare përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Plani i financimit të programit të studimit përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>UET realizon auditim të pasqyrave financiare çdo vit. E.E.I. shpk përmbush kushtet për kryerjen e një ekspertize, prandaj çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. Për pasqyrat financiare të çdo viti audituesi ligjor i pavarur ka dhënë opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit. Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor, si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. UET pas mbylljes e pasqyrave financiare kryen auditimin e jashtëm nga audituesi ligjor. Raporti i auditimit merr për bazë të gjitha informacionet dhe materialet e nevojshme në lidhje me situatën dhe performancën financiare të shoqërisë. Raporti i auditimit përmban analizën e zërave të pasqyrave financiare, si edhe opinionin në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit.</p>
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës kryen auditim të pasqyrave financiare çdo vit. E.E.I. shpk përmbush kushtet për kryerjen e një ekspertize, prandaj çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. Për pasqyrat financiare të çdo viti audituesi ligjor i pavarur ka dhënë opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit. Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor, si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë</p>	<p>Buxheti financiar hartohet në muajin tetor të çdo viti dhe miratohet nga aksioneri i vetëm Z. Henri Çili. Për zbatim të këtij buxheti, ngarkohet Administratori dhe Zyra e Financës. Projekt</p>

⁷³ Të dhëna mbi koston për student (Ref. Nr. 49); Të ardhura dhe financime të ndryshme (Ref. Nr. 50)

financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen	buxheti hartohet në mënyrë të tillë ku percaktohet çdo muaj një raport i drejtë i të ardhurave dhe shpenzimeve duke përcaktuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Për çdo veprim blerje dhe shitje zyra e financës pajiset me “Kërkesë për Lëvrim fondesh”, e miratuar nga Administratori. Veprimet e shoqërisë kryhen vetëm nëpërmjet sistemit bankar duke siguruar transparencë të plotë. Institucioni dëshmon se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Institucioni ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura të mirëpërcaktuara që nga pranimi dhe deri në përfundim të studimeve në ciklin e dytë të studimit Master Profesional. Për këtë mbështetet në legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore të tij ⁷⁴ .
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Politikat dhe procedurat në këtë program studimi, nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit Master Profesional ne Marketing ⁷⁵ .
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve	Informacioni lidhur me kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit është lehtësisht i kuptueshëm dhe i aksesueshëm nga publiku nepermjet informacioneve te vendosura ne website-n e

⁷⁴ Rregullore e UET (Ref.Nr.5); Rregullore mësimore e programit të studimit (Ref.Nr.7).

⁷⁵ Rregullore e UET, neni 11 (Ref.Nr.5); Rregullore mësimore e programit të studimit, neni 2 (Ref.Nr.7).

dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	institucionit, kontaktit me zyrën e pranimit dhe me pedagogen e keshillimit të karrierës. (Rregullore e Universitetit Europian të Tiranës, neni 11, neni 35) ⁷⁶			
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Përpara çdo viti akademik institucioni harton dhe publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve Master Profesional në përputhje me ndryshimet e mundshme në legjislacionin përkatës. www.uet.edu.al ⁷⁷ .			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit nëpërmjet informacionit në website-n e tij, pritjes dhe informimit nga këshilluesit e karrierës, komunikimit me zyrën e pranimeve, takimeve me studentët potencialë (gjimnaz tour) etj ⁷⁸ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nëpërmjet zyrës së pranimeve, zyrës së këshillimit të karrierës dhe sekretarisë institucioni vë në dispozicion dhe ofron informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe shtyrjes së studimeve në një vit tjetër akademik (Masteri Profesional normalisht zgjat 1 vit) ⁷⁹ .
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Nëpërmjet zyrës së pranimeve, zyrës së përkujdesit për studentët, zyra e këshillimit të karrierës ⁸⁰ , sekretarisë dhe departamentit përkatës institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. ⁸¹

⁷⁶ Faqja zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës www.uet.edu.al

⁷⁷ Faqja zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës www.uet.edu.al

⁷⁸ Rregullore e UET, neni 36 (Ref.Nr.5).

⁷⁹ Rregullore mësimore e programit të studimit, pika 3.2 (Ref.Nr.7); Rregullore e UET (Ref.Nr.5).

⁸⁰ Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e zyrës së këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr. 12)

⁸¹ Rregullore mësimore e programit të studimit, pika 2, pika 9, (Ref.Nr.7); Rregullore e UET, neni 11, 35 (Ref.Nr.5)

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Syllabusi i secilës lëndë përmban informacion të detajuar lidhur me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit Master Profesional. Studentët e aksesojnë atë në mënyrë direkte në UETLMS dhe në çdo moment pranë zyrës së sekretarisë ose koordinatoreve të programit të studimit specifik. Në fillim të çdo semestri, silabusi dhe kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve shpjegohen dhe diskutohen nga pedagogu⁸².</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni ka dokument të shkruar dhe ofron informacionin e duhur për studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Kjo gjë bëhet gjatë keshillimit në fillim të vitit akademik dhe më pas në semestrin e dytë dhe gjatë periudhës së përgatitjes të punimit të diplomes zhvillohen seancat metodologjike ku pedagogu udhëheq studentët përkatës për punim të diplomës apo detyrat për përmbushjen e detyrimeve lidhur me diplomimin⁸³.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike institucioni organizon takime me studentët potencialë (gjimnaz tour), aktivitete (UET open days, shkollat verore e dimërore) për të informuar të interesuarit dhe studentët e ardhshëm mbi programin e studimit⁸⁴.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Që në momentin e aplikimit, regjistrimit por edhe në vazhdim, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit Master Profesional në Marketing nga zyra e pranimeve, zyra e këshillimit të karrierës dhe pedagogët, përveçse ky informacion gjendet i publikuar në UET LMS ku çdo student ka akses⁸⁵.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të</p>	<p>Studentët e programit të studimit kanë në dispozicion informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për</p>

⁸² Rregullore mësimore e programit të studimit, pika 5 (Ref. Nr.7).

⁸³ Rregullore e UET, neni 38 (Ref.Nr.5).

⁸⁴ Rregullore e UET, neni 36, 37 (Ref.Nr.5).

⁸⁵ Rregullore mësimore e programit të studimit, (Ref. Nr.7).

programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Këto informacione dhe dokumenta merren dhe gjenden në zyrën e sekretarisë dhe koordinatorëve, në UETLMS, në website-n e institucionit. Gjithashtu në fillim të secilit semestër studentët pajisen në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike me të gjithë syllabuset e lëndëve ⁸⁶ .			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nëpërmjet zyrës së kujdesit për studentët, marrëveshjeve të krijuara me kompani dhe institucione në treg, institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i mbështet ata në mënyrë institucionale për ti orientuar në tregun e punës (UET open days, Biznese të ftuar në auditor, Alumni, biznese në aktivitete, bordet e bordit të punës etj). Zyra e keshillimit të Karrierës dhe e kujdesit ndaj studentit mbështet studentët gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve duke shpërndarë informacione mbi mundësitë e punësimit.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentët kanë informacionin e duhur mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Informohen nga zyrat përkatëse të kujdesit ndaj studentëve, sekretaria dhe koordinatorët përkatëse por edhe online nëpërmjet UETLMS ku shkëmbejnë informacion dhe materiale të ndryshme me pedagogun/studentët e tjerë lidhur me lëndën dhe programin e studimit ⁸⁷ .			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë	Informacioni në lidhje me programin e studimit gjendet në sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit (UETLMS) dhe është lehtësisht i arritshëm nga studentët jo vetëm në ambientet e institucionit por edhe në distancë, nëpërmjet kompjuterit dhe <i>smartphone</i> .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimit në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	UET disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit Master Profesional në Marketing. Nëpërmjet Shoqatës Alumni, në mënyrë periodike mbahen kontakte të vazhdueshme me ish-

⁸⁶ Faqja zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës www.uet.edu.al

⁸⁷ Rregullore mësimore e programit të studimit, (Ref. Nr.7).

	studentë me qëllim jo vetëm ndarjen e eksperiencave dhe arritjeve profesionale të gjithsecilit por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit e tregut të punës.			
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	UET disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.			
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve Master Profesional në Marketing që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre duke mbajtur në sistem të dhëna për prezencën, vlerësimin dhe stadin ku ndodhet një student lidhur me programin që ndjek ⁸⁸ .			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit (soft copy dhe hard copy) dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. IT dhe sekretaria nepermjet UMS, sekretaria (kopje fizike te procesverbaleve) ⁸⁹ .			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Në UET hartohen raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe punësimin e tyre, duke i reflektuar këto të dhëna me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve	Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre

⁸⁸ Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretaries mësimore (Ref. Nr. 9)

⁸⁹ Faqja zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës www.uet.edu.al

të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	rregullatore të vetë IAL-ve. Studentët organizohen në Këshilli studentor, në focus grupet e vlerësimit të lëndëve dhe pedagogëve, nëpërmjet vlerësimit online për pedagogun etj ⁹⁰ .			
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	UET garanton përfshirje reale, konkrete, dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme të studentëve në vendimmarrje (qeveria studentore), këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, pedagogët që u japin mësim etj. Këto të dhëna mbahen nga Zyra e kujdesit për studentët ⁹¹ .			
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Në përputhje me legjislacionin në fuqi, institucioni mban parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe ka procedurë joburokratike të njohjes së studimeve të mëparshme ⁹² .			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Nëpërmjet angazhimit çdo muaj në mbledhjet e hapura të departamentit, studentët kanë mundësinë të përfshihen në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit. Gjithashtu ata mund të japin mendimet online në çdo moment nëpërmjet UET LMS dhe duke komunikuar direkt me departamentin përkatës.			
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësisë/pedagogut përgjegjës.	Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e pedagogut përgjegjës. Pas çdo provimi organizohen dhe kryhen seancat sqaruese në të cilat studentët kuptojnë dhe komunikojnë me pedagogun përkatës lidhur me vlerësimin dhe mundësinë për rishikim të vlerësimit ⁹³ .			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

⁹⁰ Dokuenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit nda studentit (Ref. Nr. 12); Faqja zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës www.uet.edu.al (Ref.Nr.47)

⁹¹ Rregullore e UET, neni 22 (Ref. Nr. 5).

⁹² Rregullore mësimore e programit të studimit, pika 9, (Ref. Nr. 7)

⁹³ Rregullore mësimore e programit të studimit, pika 5, (Ref. Nr. 7)

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	UET ka krijuar dhe përdor procedura në shërbim të informimit të studentëve lidhur me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve ⁹⁴ .
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .	UET ka një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen, asistimin e studentëve për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Kjo bëhet kryesisht nëpërmjet zyrës së kujdesit ndaj studentëve, dekanit të studentëve por edhe me anë të sistemit UETLMS ku ofrohen informacione të përditësuara për procesin mësimor dhe programin e studimit. Baza e të dhënave për studentin përfshin edhe emailin që shërben si një tjetër mjet për informim dhe këshillim nga zyrat përkatëse dhe kordinatorët ⁹⁵ .
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në UET funksionon zyra për këshillimin e karrierës që ofron mënyrë të vazhduar dhe periodike informacion dhe orientim të posaçëm, këshillim të karrierës lidhur me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës ⁹⁶ .
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	Zyra për këshillimin e karrierës dhe Shoqata Alumni ndjekin studentët pas diplomimit duke mbledhur, përpunuar dhe mbajtur të dhëna mbi punësimin e studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse.

⁹⁴ Rregullore mësimore e programit të studimit, Kreu X. neni 6, pika 3, (Ref. Nr. 7)

⁹⁵ Rregullore e UET, neni 6, pika 1.3, (Ref. Nr. 5)

⁹⁶ Rregullore e UET, neni 6, pika 1.3, (Ref. Nr. 5)

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Institucioni i kushton vëmendje të veçantë sigurimit të brendshëm të cilësisë, për të garantuar që veprimtaria e tij jo vetëm është në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, të Statutit dhe të akteve të tjera të brendshme rregullatore, por gjithashtu që objektivat strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit vazhdojnë të qëndrojnë në themel dhe të drejtojnë punën e përditshme të strukturave drejtuese dhe personelit ⁹⁷
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve ad hoc, dhe që nga Janari 2011 në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit ⁹⁸ . Komisioni vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore të UET-it. Ai ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Ngritja e organeve këshilluese si Bordet e Tregut të Punës, sikurse dhe angazhimi në KSBC i një eksperti të jashtëm, i përgjigjet gjithashtu nevojës së institucionit për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm. Strukturë tjetër e rëndësishme në sigurimin e brendshëm të cilësisë është dhe Zyra e Standardeve dhe Cilësisë (ZSC), roli i së cilës është të zhvillojë politikat, strategjitë, proceset dhe udhëzimet, në funksion të rritjes së cilësisë në UET, si edhe të monitorojë zbatueshmërinë korrekte të tyre nga njësitë akademike dhe administrative.
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në	Sigurimi i cilësisë realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, monitorimit nga ana e strukturave drejtuese, ZCS, KSBC-së, tërheqjes së mendimit të studentëve, të anëtarëve të Bordeve të Tregut të Punës si edhe bashkëpunimit me

⁹⁷ Statuti UET, Neni 11 & 16 (Ref. Nr. 2); Rregullore UET, Neni 6 (Ref. Nr. 5); Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. Nr. 8)

⁹⁸ Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC (Ref. Nr. 30);

arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore. Universiteti Europian i Tiranës i është nënshtruar në mënyrë periodike vlerësimeve të jashtme, të lidhura me akreditimin e parë dhe periodik institucional (me vlerësim përfundimtar pozitiv dhe me një kohëzgjatje prej 5 vite akademike) sikurse dhe të programeve të studimit, kontrollit të ligjshmërisë të ushtruar nga MASR në vitin 2014, sipas së cilit UET i plotësonte standardet dhe kriteret ligjore; vizitat monitoruese të MASR mbi kapacitetet akademik dhe infrastrukturore në funksion të miratimit të kuotave për çdo vit akademik.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Veprimtarinë e saj KSBC-ja e mbështet në dokumente strategjik ⁹⁹ dhe e zhvillon të organizuar sipas një plani kalendar (Planit të veprimit) të përvitshëm, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse ¹⁰⁰ . Në mënyrë periodike KSBC informon drejtuesit e njësive, e përmes tyre të gjithë stafin e UET-it rreth rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.	KSBC-ja vepron në nivel institucional dhe është përgjegjëse për monitorimi e cilësisë në të gjithë programet e studimit. Në funksion të garantimit të cilësisë, rol të rëndësishëm përveç KSBC-së kanë Departamentet si njësia përgjegjëse për programin e studimit, ku përgjegjësit e grup-lëndëve/ kordinatorët e programeve luajnë një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim. Bordet e tregut të punës kanë gjithashtu një kontribut të rëndësishëm pasi reflektojnë dinamikat dhe kërkesat që vijnë nga tregu. Këto rekomandime bëhen bazë për ndryshime në kurrikula në funksion të përshtatjes sa më mirë me këto kërkesa.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e	UET përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Këto

⁹⁹ Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2017-2022 (Ref. Nr. 37.3); Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (Ref. Nr. 37.1)

¹⁰⁰ Plani Veprimit_KSBC_2018-2019 (Ref. Nr. 37.2)

herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel Rektorati sikurse dhe në nivel departamenti ¹⁰¹ .			
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	UET përdor metodologji dhe instrumente vlerësimi për ecurinë e programeve të studimit dhe aktiviteteve të tjera akademike. Aktivitetet me karakter monitorues dhe vlerësues që organizohen nga KSBC, për secilin nga proceset akademike që monitorohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë Rektoratit dhe Dekanateve të fakulteteve. Njëherazi, rekomandon detyra, zbatimin e cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe vetë KSBC.			
Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Ky kriter plotësohet pasi rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit përpilohen në formë dokumenti dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse sikurse dhe titullarit të lëndës, përgjegjësve të grup-lëndëve, përgjegjësit të departamentit, etj			
Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Raportet e vlerësimit evidentojnë përputhshmërinë e aktiviteteve me aktet rregullatore dhe standardet e cilësisë. KSBC dhe strukturat e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë monitorojnë procesin e marrjes së masave në kuadër të adresimit të mangësive			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Vlerësimi nga KSBC bëhet në nivel institucional dhe si i tillë shtrihet në të gjithë programet e studimit dhe nuk hartohen relacione specifike në bazë programi, por nga analiza e përgjithshme secili nga Departamentet përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit evidenton elementët që lidhen me programet specifike. Këto vlerësime janë pjesë e vetëvlerësimeve në kuadër të akreditimit institucional dhe programeve të studimit.
Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën	të drejtpërdrejta si dhe instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. Disa prej metodave që UET përdor për kryerjen e vlerësimeve përfshijnë monitorimi i elementëve të lidhur me proceset akademike si provimet, silabuset,

¹⁰¹ Format relacioni per monitorimin e silabuseve (Ref. Nr. 37)

e fushës akademike të programit të studimit.	literatura e përdorur, etj. Një vend të veçantë zë dhe përfshirja e studentëve në këto procese. Në strukturën e KSBC është një përfaqësues i Këshillit të Studentëve. Instrumentet kryesor që përdoren për përfshirjen e studentëve janë edhe zhvillimi i pyetësorëve online, fokus grupet, mbledhjet e hapura të departamenteve, etj.			
Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<p>UET, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Teste të standardizuara; • Dëgjime në auditor; • Vlerësimi me pikë; • Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; • Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët; • Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës <p>Për stafin akademik të kategorisë Lektor dhe Asistent Lektor, zhvillohen dhe vizitat nga eprori (Përgjegjësi/Dekani) gjatë zhvillimit të një ore mësimi. Ky proces përfundon me plotësimin e një raporti vlerësimi.</p>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	<p>Institucioni kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodash të tërthorta, kryesisht në formën e sondazheve me të gjithë studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët¹⁰². Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. Kujdes i kushtohet intervistave me studentët, si edhe ato me pedagogët gjatë shqyrtimit të performancës së tyre.</p> <p>Të tërthorta:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, • Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; • Pyetje konceptuale; <p>Intervista.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi

¹⁰² G-III-4-2 Fomrati i vlerësimit të pedagogut nga studentët (Ref. Nr. 40)

<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Ngritja e organeve këshilluese si Bordet e Tregut të Punës, sikurse dhe angazhimi në KSBC i një eksperti të jashtëm, i përgjigjet gjithashtu nevojës së institucionit për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm. UET ka arritur të sigurojë përfshirjen si partner në dy projekte europiane që kanë në fokus sigurimin e cilësisë së brendshme nga institucionet e arsimit të lartë (projekti TEMPUS 'ENCHASE'¹⁰³ dhe Erasmus+ QAINAL¹⁰⁴). Aspektet pozitive të përfshirjes në këto projekte lidhen me shkëmbimin e përvojave, njohja me qasje të reja dhe të ndryshme, trajnimet dhe vizitat studimore, sikurse dhe me rishikimin e akteve rregullatore, metodologjisë dhe instrumenteve për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Përgjegjësitë dhe detyrat e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit të përmendura në kriteret e mësipërme.</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në dokumentin që rregullon veprimtarinë e lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e aktorëve të angazhuar¹⁰⁵. Komisioni i Sigurimit të Cilësisë përbëhet nga Kryetari i Komisionit, një përfaqësues nga pedagogët e çdo Fakulteti, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik, ose administrativ, një përfaqësues nga Këshilli i Studentëve, si dhe të paktën një përfaqësues ekspert i jashtëm.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në përzgjedhjen e anëtarëve merren parasysh kriteret e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Kompetencat profesionale; b) Paanshmëria; c) Mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe d) Shkalla e nevojshme e njohjes të anëtarëve të Komisionit; e) Të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET-it
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të</p>	<p>Angazhimi i ekspertit të jashtëm në strukturën e KSBC-së, takimet me Bordin e Tregut të Punës, pjesëmarrja në projekte të lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë janë tregues të angazhimit të aktorëve të jashtëm në proceset e lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p>

¹⁰³ Fisha e projektit ENCHASE (Ref. Nr. 37.5)

¹⁰⁴ Fisha e projektit QAINAL (Ref. Nr. 37.4)

¹⁰⁵ Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. Nr. 8)

vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Veprimtarinë e saj KSBC-ja e zhvillon të organizuar sipas një plani kalendar (Planit të veprimit) të përvitshëm, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Duke marrë në konsideratë faktin se raportet e KSBC-së përmbajnë të dhëna sensitive dhe personale, ato bëhen pjesë e diskutimeve në ato grupe për të cilat Raporti ka ndikim të drejtpërdrejtë. Raporti në tërësi i shpërndahet drejtuesve, ndërsa në departamente diskutohen vetëm ato pjesë të raporteve që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me atë departament. Në ato raste kur të dhënat vlerësohen se kanë një sensibilitet të lartë, rastet trajtohen nga strukturat drejtuese me personin konkret në takime individuale.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Të dhënat e përftuara nga vetëvlerësimet periodike shërbejnë jo vetëm për analizimin e situatës por edhe për identifikimin e problematikave me synim marrjen e masave për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë së brendshme. Skedat e pyetësorëve përpunohen përmes programit të përdorur për vlerësimin online dhe i vihen në dispozicion drejtuesve të institucionit, si edhe në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog. Të dhënat e fituara nga instrumentet e vetëvlerësimeve periodike, pas përpunimit shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit të folloë up-it, gjatë të cilit drejtuesit e institucionit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik ¹⁰⁶ . Në bazë të natyrës së problematikave të evidentuara nëpërmjet pyetësorëve, janë marrë masa, të cilat variojnë nga zhvillimi i seminareve trajnuese dhe deri tek masat konkrete për pedagogët të cilët mund të kenë shfaqur problematikë të vazhdueshme. Në kuadër të politikave të përmirësimit të cilësisë mund të përmendim:

¹⁰⁶ G-I-12-1 Formulari i vetvlerësimit të performancës së personelit akademik (Ref. Nr. 41)

	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimin e trajnimeve të vazhdueshme të fokusuara kryesisht në aspektet didaktike të mësimdhënies dhe kërkimin shkencor; • Inkurajimi dhe mbështetja e stafit akademik për pjesëmarrjen në aktivitete zhvilluese, si brenda ashtu edhe jashtë vendit; • Bashkëpunimi ndërkombëtar në kuadër të shkëmbimit të stafit nëpërmjet përfshirjes në programin Erasmus+. 			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Të gjithë dokumentet, procedurat dhe instrumentet e përmendura në kriteret e mësipërme dëshmojnë kwtw fakt			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Ashtu si stafi akademik dhe studentet përfshihen në sigurimin e brendshëm të cilësisë. Kjo gjë garantohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga përfshirja e tyre në strukturat e garantimit të cilësisë por edhe në mënyrë të tërthortë duke qenë se veprimtaria i bëhet e ditur si stafit akademik ashtu edhe studentëve. Informacioni për studentët shpërndahet nëpërmjet: <ul style="list-style-type: none"> • Rregulloreve; • Studentëve të përfshirë në struktura të ndryshme brenda institucionit (KSBC, Senat Akademik); • Këshillit të studentëve; • Javës së orientimit (e cila zhvillohet në fillim të vitit akademik). 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Marketing” me profile të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti European i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Nivel i lartë i kualifikimit të stafit akademik. Nëpërmjet një personeli të kualifikuar mësimdhënës, drejtues, administrativ e mbështetës synohet garantimi i një shërbimi cilësor bashkëkohor ndaj studentëve nga të gjitha njësitë përbërëse. Pedagogët në këtë program studimi kanë gradat dhe eksperiencën e duhur për të ofruar shërbimin ndaj studentëve.
2. Qëndrueshmëria e personelit efektiv akademik. Personelit efektiv është i angazhuar prej dy ose më shumë vitesh në aktivitetin akademik të këtij programi studimi. Ky është një indikator i rëndësishëm që tregon se stafi i tanishëm i UET është më i përkushtuar, ka mundësi t'i qendrojë më afër studentit dhe ka të gjitha mundësitë të përmirësojë nivelin e performancës.
3. Literaturë bashkëkohore. Literatura e përdorur në këtë program studimi dhe në programet e tjera në UET është bashkëkohore dhe përdoren libra/tekste nga autorët dhe shtëpitë botuese më të njohura në botë lidhur me literaturën akademike.
4. Format bashkëkohore të kontrollit të njohurive dhe vlerësimi i studentëve. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm duke rritur nivelin e objektivitetit dhe transparencën në vlerësimin e studentit. Gjatë vitit akademik 2016-2017 ka filluar të përdoret vlerësimi në mënyrë elektronike (nëpërmjet Clean Score) i provimeve/testimeve.
5. Informatizimi i sistemit dhe implementimi i sistemit LMS rrit mundësitë për informim dhe komunikim më të shpejtë, cilësor, transparent dhe efektiv për studentët, duke kontribuar në lehtësimin e procesit mësimor.
6. Vlerësimi i performancës. Sistemi i vlerësimit të performancës është në funksion të cilësisë së mësimdhënies, synon arritjen e objektivave dhe standarteve bashkëkohore, është vlerësim 360° dhe bazohet në treguesit e performancës.
7. Partneritet i rritur dhe network i gjerë kombëtar dhe ndërkombëtar. Zgjerimi i kontakteve të UET me universitete të tjera të vendeve të zhvilluara të BE-së dhe vende të tjera të Europës, jo vetëm nëpërmjet konferencave, por nëpërmjet pjesëmarrjes në mësimdhënie, njohjes me metodat kërkimore e shkencore si edhe nëpërmjet zbatimit të projekteve të përbashkëta (mobilitete të stafit akademik, administrativ dhe të studentëve në të tre nivelet, si dhe projektet Erasmus +, por jo vetëm).
8. Forcimi i edukimit sipërmarrës nëpërmjet traditës së krijuar tashmë në disa evente tipike për universitete të orientuara ndaj iniciativës sipërmarrëse; përfshirjes së CEO-ve, menaxherëve të nivelit të lartë dhe sipërmarrësve të suksesshëm në leksione të hapura e aktivitete, dhe lidhjes UET-biznes ka reflektuar në programet tona nevojat që ka tregu ndaj kompetencave të nevojshme dhe ka rritur interesin e studentëve ndaj këtyre programeve.

Pikat e dobëta:

1. Biblioteka UET. Pavarësisht nga puna e bërë, pasurimi i Bibliotekës së UET mbetet një ndër sfidat kryesore të këtij institucioni universitar. Jo të gjitha lëndët kanë literaturën e fundit në gjuhën shqipe.
2. Mungesa e ofrimit në program e lëndëve mësimore në gjuhë të huaj
3. Plagjatura. Edhe pse përdoret sistemi anti plagjaturë, ende mungon një bazë të dhënash e unifikuar në nivel kombëtar (për gjuhën shqipe), që do të lehtësonte identifikimin e plagjiaturave në punimet e studentëve (ese/detyra/diploma).

Lista e dokumenteve bazë për procesin e akreditimit të programeve të studimit

Lista e mëposhtme është dokumentacion i detyrueshëm që institucionet duhet të dorëzojnë së bashku me RVB në kuadër të akreditimit të programit të studimit. Nuk është e thënë që çdo pikë e mëposhtme duhet të jetë një dokument i veçantë; mundet që në një dokument mund të përmbliken disa nga të dhënat e kërkuara.

Në rastet kur dokumenti është ndryshuar totalisht ose pjesërisht, citimi i tij duhet të reflektojë edhe ndryshimet e bëra (ose të bashkëngjiten të dy dokumentet). Gjithashtu mund të përdoren evidenca të tjera që Institucioni ka në funksionin e tij.

Lista e dokumentave përmban **emërtimin e plotë të dokumentit** (psh statuti etj), ndërsa në Raport duhen cituar **edhe pjesët përkatëse të tij (psh statuti i IAL, neni x, pika y).**

Në rastin e mbështetjes / citimit në ligjet/aktet ligjore, këto dokumenta duhet të jenë pjesë e listës së mëposhtme (pjesërisht/ose plotësisht)

1. Mendimi i Dekanit
2. Statuti i UET;
3. Plani strategjik 2015-2020;
 - 3.1. Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020
4. MP Marketing Plani strategjik;
5. Rregullore e UET;
6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit;
7. Rregullore mësimore MP Marketing
 - 7.1. Dokumenti A.IV Sistemi i vlerësimit të studentëve;
 - 7.2. Formati i tezës së provimit përfundimtar;
8. Dokumenti F.VII Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë;
9. Dokumenti E.I Mbi funksionimin e Sekretarisë mësimore
10. Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit;
11. Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore;
 - 11.1. Shembull thirrje për staf akademik;
12. Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit;
13. Rregullore e zyrës /njësisë së monitorimit të Kurrikulës;
14. MP Marketing kurrikula e programit;
 - 14.1. MP Marketing_Plani Mësimor
15. Modeli i diplomës;
 - 15.1. Suplementi i diplomës;

16. Studimi për tregun e punës përpara hapjes së programit (dokument i procesit të hapjes);
17. Studimi (periodik) për tregun e punës, pas daljes së studentëve (**zhvillohet 6 muaj pas përfundimit të vitit akademik**);
18. Plotësimi i rekomandimeve nga vlerësimi i brendshëm i cilësisë dhe/ose akreditimi i mëparshëm;
19. Syllabuset e lëndëve të ofruara në vite
 - 19.1.Formati i Syllabusit Cikli i parë dhe i dytë;
20. CV e stafit akademik të programit të studimit
21. CV e stafit akademik udhëheqës i diplomave (në rastin kur nuk është pjesë e stafit akademik të programit)-**nuk ka**.
22. CV e stafit ndihmës akademik- **nuk ka**
23. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në Njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse
24. Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin studimit;
25. Të dhëna Tabelore me ngarkesën e plotë mësimore të stafit akademik, në të gjitha programet e studimit;
26. Të dhëna për numrin e programeve që ofrohen nga Njësia përgjegjëse
27. Cilësia në hyrje MP Marketing;
 - 27.1.Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin;
 - 27.2.Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin, këshillimin akademik dhe këshillimin metodologjik;
28. Dokumenti D.II, Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin;
29. Tabelë përmbledhëse për punësimin real të studentëve (**të dhënat mbledhen 6 muaj pas përfundimit të vitit akademik**)
30. Të dhëna për individët e angazhuar në KSBC;
31. Të dhëna për kodifikimin e programit të studimit (mbështetur në LAL 80/2015), apo Udhëzimeve Kombëtare e Europiane (**nuk ka dale udhëzimi nga MASR**);
32. Tabelë përmbledhëse me institucionet bashkëpunuese, për programin e studimit dhe për praktikën profesionale;
33. Tabelë përmbledhëse për trajnimet profesionale të mëtijshme, për studentët e diplomuar;
34. Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj dhe për praktikën profesionale;
35. Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve;

36. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit; Detyrat e koordinatorit të programit;
37. Format relacioni për monitorimin e silabuseve;
 - 37.1.Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë;
 - 37.2.Plani veprimit i KSBC;
 - 37.3.Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë;
 - 37.4.Fisha e projektit QAinAL;
 - 37.5.Fisha e projektit ENCHASE;
38. Analizë e Departamentit përgjegjës (vjetore/periodike) mbi arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënësve dhe aftësisë profesionale;
39. Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës
40. G-III-4-2 Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët;
 - 40.1.D-VI-3-3 Formular për ankesat e studentëve;
41. G-I-12-1 Formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik;
42. Të dhëna të plota për infrastrukturën;
43. Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programit;
 - 43.1.Trajnim mbi sistemin UET LMS;
 - 43.2.Trajnimi Data Analysis of ESS 2012 Project
44. Formati i Dosjes personale të stafit akademik me kohe të plote;
 - 44.1.Stafi akademik me kohe të pjesshme;
45. Formular për pasurimin e literaturës në bibliotekë;
 - 45.1.Dokumentet E IV. Mbi funksionimin e bibliotekës;
46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS;
 - 46.1.Urdhër mbi zbatimin e LMS;
47. Faqja zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës www.uet.edu.al
48. Dokumenti E.V. Politikat e prezantimit dhe promovimit të UET online;
49. Të dhëna mbi koston për student;
50. Të ardhura nga financime të ndryshme;
51. Politika e marketing-ut të programit të studimit;
52. Procedura për ndryshimin e kurrikulës (**programi është riorganizuar**);
53. Ligji dhe akte nënligjore
54. Licensime dhe akreditime
 - 54.1.Urdhëri i akreditimit

55. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020